



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 45, datë 23.07.2025

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË QËNDRUESHËM PËR ENERGJINË
DHE KLIMËN (SECAP) TË BASHKISË Durrës 2030**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", Ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" i ndryshuar, Ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike", Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 106, datë 16.12.2024 "Për dhënien e miratimit Kryetarit të Bashkisë për nënshkrimin e Konventës së Kryetarëve të Bashkive për Klimën dhe Energjinë" si dhe sipas relacionit të hartuar nga grupi i punës i ngritur me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 37, datë 13.01.2023 i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

1. Miratimin e planit të veprimit të qëndrueshëm për energjinë dhe klimën (SECAP) të Bashkisë Durrës 2030, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi administrata e Bashkisë Durrës.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

ZËVENDËSKRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK Durrës

Denisa Luarasi

U shpall sot me datë 24.07.2025



BASHKIA
DURRËS

PLANI I VEPRIMIT PËR ENERGJINË E QËNDRUESHME DHE KLIMËN (SECAP) DERI NË VITIN 2030

BASHKIA DURRËS



Përmbajtja

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1. STRATEGJIA	5
2. HYRJE	6
2.1. Vizioni bashkisë	6
2.2 Qëllimet	6
2.2.1 Konventa e Krye-Bashkiakëve për Energjinë e Klimën (CoM)	6
2.2.3 Objektivat e CoM dhe Plani i Veprimit	7
2.3. Struktura dhe organizimi i Bashkisë	9
2.3.1. Organograma	9
2.3.2. Njësitë përgjegjëse për zbatimin e SECAP	9
2.4 Metodologjia dhe Procesi i SECAP	10
2.4.1 Informacion i përgjithshëm rreth metodologjisë dhe përmbajtjes së SECAP	10
2.4.2 Procesi i SECAP	11
2.4.3 Fazat përgatitore	12
2.4.4 Zbatimi dhe monitorimi i procesit	13
2.5. Kuadri ligjor për zhvillimin e SECAP	15
2.5.1. Në nivel të Bashkimit Evropian	15
2.5.2. Në nivel kombëtar	16
2.5.3. Në nivel rajonal	17
2.5.4. Në nivel vendor	17
2.6. Përfshirja e aktorëve	18
2.7. Procesi i Monitorimit dhe Vlerësimit	18
2.8. Të dhëna rreth Bashkisë Durrës	19
2.8.1. Vlerësimi i mundësive për përshtatjen	20
2.8.2. Adresimi i situatave ekstreme të klimës	21
3 INVENTARI BAZË I SHKARKIMEVE (BEI)	23
3.1 Hyrje	23
3.2 Metodologjia dhe qasja e hartimit të BEI	23
3.2 Analiza e konsumit të energjisë dhe shkarkimeve të gazrave serë sipas sektorëve	25
3.2.1 Analiza për sektorin e ndërtesave pajisjeve dhe impianteve ('Ndërtesat')	25
3.2.2 Analiza për sektorin e transportit	30
3.2.3 Analiza e Sektorëve jo-energetikë – Sektori i Mbetjeve, Bujqësia dhe pyjet	34



3.3 Analiza e përgjithshme e konsumit të energjisë dhe shkarkimeve të gazeve serë në territorin e bashkisë	35
4. VLERËSIMI I RREZIKUT DHE CENUESHMËRISË (RVA)	40
4.1 Metodologjia për vlerësimin e cenueshmërisë dhe rrezikut nga ndryshimet klimatike të Bashkisë Durrës.	40
4.1.1 Termat bazë të vulnerabilitetit	41
4.2 Ndryshimet klimatike	44
4.2.2 Vlerësimi i ndryshimeve klimatike të ardhshme në zonën e qytetit të Durrësit	44
5 MASAT ZBUTËSE	51
5.1 Qasja në përzgjedhjes së masave zbutëse	51
5.2 Detajet e masave zbutëse	52
5.2.1 Sektori i ndërtesave – ndërtesat publike në pronësi të bashkisë	52
5.2.2 Sektori i ndërtesave – ndërtesat private të banimit dhe tregtare	65
5.2.3 Sektori ndërtesave – Ndriçimi publik	73
5.2.4 Ndër-sektoriale – Sektori i Ndërtesave	76
5.2.5 Sektori i transportit – Flota e automjeteve bashkiake dhe transporti publik rrugor	80
5.2.6 Sektori i transportit – transporti privat dhe tregtar	83
5.2.7 Sektori: Bujqësia, pyjet dhe përdorimet e tjera të tokës	91
5.2.8 Mbetjet e ngurta bashkiake	96
5.3. Aspekte financiare	103



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Planin e Veprimit për Energjinë e Qendrueshme dhe Klimën (SECAP) i Bashkisë Durrës përcakton veprimet e zbutjes dhe të përshtatjes për energjinë dhe ndryshimet e klimës, të cilat nevojiten të ndërmerren në nivelin e qeverisjes vendore, dhe të cilat i bashkohen veprimeve në nivelin e qeverisjes qendrore, duke kontribuar së bashku në përmbushjen e objektivave kombëtare për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimit të klimës deri në vitin 2030.

Ky plan është hartuar në periudhën 2023-2024 përmes përfshirjes së një grupi të gjerë specialistësh vendore të sektorëve të ndryshëm, të ekspertëve kombëtare dhe me mbështetjen e GIZ.

Bashkia Durrës, nënshkruese e Konventës së Kryetarëve të Bashkive ka detyrimin të hartojë Planin e Veprimit për Energjinë e Qendrueshme dhe Klimën (SECAP). Ajo ngre strukturën zbatuese dhe monitoruese për këtë plan dhe do të vijojë me raportimin e rezultateve të këtij zbatimi sipas periudhave kohore të kësaj Konvente për të arritur synimin e uljes së shkarkimeve me 40% krahasuar me vitin bazë 2015.

Plani përmban Inventarin Bazë të Emetimeve (BEI) për të përcaktuar dhe krahasuar ndikimin e aktiviteteve zbutëse dhe Vlerësimin e Riskut dhe Cenueshmërisë (RVA) të sektorëve përkatës të aktiviteteve ndaj ndryshimeve klimatike.

Vlerësimi i shkarkimeve në vitin bazë 2015 vlerësohet në 505 843 ton CO₂. Zbatimi i 40 masave të zbutjes dhe përshtatjes në sektorët e a) Ndërtesave, b) Transportit, c) Bujqësisë, pyjeve dhe përdorimit të tokës dhe d) Mbetjet urbane pritet të ketë një efekt në zvogëlimin e shkarkimeve të CO₂ në 281 758 tonë CO₂ ose 44.3% më pak se sa viti bazë.



1. STRATEGJIA

Strategjia për Energji të Qëndrueshme dhe Klimën është një dokument strategjik vendor i cili synon të identifikojë dhe prioritetizojë veprime që rrisin shkallën e përshtatjes ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike dhe kontribuojë në objektivat kombëtare të klimës dhe energjisë. Ajo synon të ngrejë strukturat dhe mjetet e nevojshme për të arritur objektivat e vendosur për uljen e shkarkimeve në masën 40% krahasuar me vitin bazë (2015) të vlerësimit të shkarkimeve dhe të mbështesë të gjithë nismat për organizimin institucional, rritjen e kapaciteteve vendore dhe përfshirjen e komunitetit në zbatimin e tyre. Kjo strategji shkon në të njëjtën linjë me dokumentat e tjerë strategjikë të Bashkisë Durrës dhe harmonizon objektivat e zhvillimit të kësaj bashkie me ato të energjisë dhe klimës.

Strategjia zhvillimore e qytetit të Durrësit e shprehur qartë dhe në dokumentin “Strategjia Territoriale Bashkia Durrës 2015-2030”, synon rritje të cilësisë së jetës së banorëve, dhe reduktimin e pabarazisë si brenda Bashkisë, ashtu dhe mes Bashkisë Durrës dhe rajoneve të tjera të ngjashme Ballkanike dhe të Europës Jug---Lindore.¹

Bashkia Durrës do të synojë të ofrojë për banorët e saj: jetesë cilësore; mundësi zgjedhjeje për cilësi të lartë në shkollim; orientim profesional për punësim të kënaqshëm; akses të kollajtë në shërbime administrative vendore dhe mundësi për pjesmarje në politikat zhvillimore të bashkisë, lehtësim për mobilitet lokal dhe rajonal, përmirësim të infrastrukturës rrugore, portuale, hekurudhore dhe ujore, gjithmon në funksion të mbrojtjes mjedisore nëpërmjet reduktimit të mbetjeve si të atyre industriale ashtu dhe urbane.

¹ Strategjia Territoriale Bashkia Durrës 2015 — 2030



2. HYRJE

2.1. Vizioni bashkisë

Bashkia Durrës synon të bëhet: (i) platformë shkëmbimi e kompletuar me logjistikë mbështetëse për flukset kombëtare dhe ndërkombëtare të mallrave, energjisë dhe personave, (ii) qendër zhvillimi ekonomik tërheqëse për investimet e huaja, dhe (iii) qendër urbane policentrike e pjesshme që ofron shërbime cilësore ndaj qytetarëve të saj, dhe vizitorëve.²

Realizimi i vizionit të Bashkisë Durrës 2030 do të kryhet përmes zbatimit të tre politikave strategjike zhvillimore, ku secila prej tyre detajohet në objektiva, masa zbatimi, programe dhe projekte.

Politika Strategjike I: *Durrësi, platformë shkëmbimesh & nyje logjistike në shërbim të rajonit të Ballkanit dhe Europës Jug---Lindore;*

Politika Strategjike II: *Durrësi atraktiv për investitorët strategjikë & motor zhvillimi ekonomik në Shqipëri;*

Politika Strategjike III: *Durrësi për qytetarët.*

Politikat e zhvillimit të territorit të Bashkisë Durrës, mbështetet në dy shtylla kryesore me ndikim në zhvillimin ekonomik të përcaktuara në nivel kombëtar dhe lokal:

- a) Durrësi, ndikimi i tij në zhvillimin ekonomik kombëtar; dhe
- b) Zhvillimi socio---urban---ekonomik lokal i Durrësit.

Për shkak të specifikës që mbart territori i Bashkisë Durrës secila prej dy shtyllave është ndarë në politika të cilat zbërthehen në objektiva strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe në masa konkrete për realizim brenda periudhës kohore të 15 viteve.

Durrësi ndikohet drejtpërdrejt nga politikat dhe investimet strategjike në nivel kombëtar, rajonal dhe Evropian (CORE Networks, TEN---T, etc). Si pasojë, politikat strategjike të zhvillimit të Bashkisë do të ndërtohen mbi këto parametra me synim rritjen e përfitimit për Durrësin dhe mënjanimin eksternaliteteve negative.

2.2 Qëllimet

2.2.1 Konventa e Krye-Bashkiakëve për Energjinë e Klimën (CoM)

CoM është nisma më e madhe ndërkombëtare e përqendruar në aktivitetet vendore të energjisë dhe klimës, me qëllim uljen e konsumit të energjisë, të shkarkimeve të gazrave serë (me fokus CO₂), dhe zvogëlimin të ndikimit dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Autoritetet vendore



² Strategjia Territoriale Bashkia Durrës 2015 --- 2030

– nënshkruese të konventës e ndajnë vizionin e përbashkët për dekarbonizimin dhe qëndrueshmërinë e qyteteve përkatëse, njëkohësisht duke ju siguruar qytetarëve të tyre siguri të furnizimit me energji të përbalueshme për të gjithë. Kjo nismë synon t'ju sigurojë autoriteteve vendore një kornizë të harmonizuar metodologjike të mbledhjes dhe përpunimit dhe raportimit të të dhënave mbi reduktimet e shkarkimeve të gazrave serë.

Nisma e CoM është lancuar në vitin 2008 nga Komisioni Evropian pas adoptimit të Paketës së EU për Energji dhe Klimë të 2007, për të mbështetur përpjekjet e autoriteteve vendore për zbatimin e politikave të qëndrueshme të energjisë dhe dekarbonizimit, me qëllim të arritjes së objektivave të vitit 2020.

Në tetor 2015, pas një procesi konsultimi me palët nënshkruese mbi të ardhmen e CoM, Komisioni Evropian ka iniciuar CoM të integruar që ka tejkaluar objektivat e vitit 2020. CoM i integruar ka zgjeruar diapazonin kohor gjer në vitin 2030 ku përveç reduktimit të konsumit të energjisë dhe shkarkimit të gazrave serë ka përfshirë edhe aspektet e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. CoM i integruar është bazuar në 3 shtylla kryesore:

- Zbutjen e ndryshimeve klimatike (përmes arritjes së objektivave deri në vitin 2030);
- Përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike;
- Sigurimin e energjisë së qëndrueshme dhe të përbalueshme për qytetarët.

2.2.3 Objektivat e CoM dhe Plani i Veprimit

Ky objektiv kryesor përfshin:

Objektiv madhor dhe qëllimi i përbashkët i CoM është reduktimi i shkarkimeve të gazrave serë (me focus në CO₂) për së paku 40% gjer në vitin 2030 krahasuar me vitin referent.

- Dekarbonizimin e territorit të bashkive nënshkruese të CoM, duke kontinuar në mbajtjen e nivelit global të ngrohjes nën +2°C krahasuar me temperaturat e periudhës 'para-industriale', në përputhje me Marrëveshjen e Parisit (COP 21) të vitit 2015;
- Territori e bashkisë të jetë më rezistent ndaj ndikimeve të dëmshme të ndryshimeve klimatike;
- Qasje universale në shërbimet të qëndrueshme dhe cilësore energjetike, me çmime të përbalueshme, për të rritur sigurinë e furnizimit me energji dhe cilësinë e jetës së qytetarëve;

VIZIONI I SECAP PËR BASHKINË Durrës

Deri në vitin 2050, Durrësi do të jetë një lider në jetesën urbane të qëndrueshme duke arritur një reduktim me 40% të CO₂ deri në vitin 2030 përmes masave të efikasitetit të energjisë, përmirësimit të transportit publik, krijimi i hapësirave rekreative të gjelbra. Do të kontribuojmë në zhvillimin ekonomik, ruajtjen e mjedisit, në gjetjen e burimeve të pastër energjisë dhe në ndikimin pozitiv ndaj klimës.



Për të arritur këtë objektiv, zotimet politike duhet përkthyer në masa dhe projekte konkrete; në këtë kuptim bashkitë nënshkruese të CoM marrin detyrimin të hartojnë Planin e Veprimit për Energji dhe Klimë të Qëndrueshme – SECAP.

SECAP-i duhet të përmbajë Inventarin Bazë të Shkarkimeve (BEI) për të përcjellë dhe krahasuar ndikimin e aktiviteteve zbutëse dhe Vlerësimin e Riskut dhe Cënueshmërisë (RVA) të sektorëve përkatës të aktiviteteve ndaj ndryshimeve klimatike. Normalisht SECAP përmban planet e vecanta të veprimeve për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.

Plani i masave zbutëse

Masat zbutëse synojë reduktimin e konsumit të energjisë nga përdoruesit fundorë, dhe në reduktimin e shkarkimeve të gazrave serë, në territorin e bashkisë; rrjedhimisht janë planifikuar të ndërmerren masa që i përkasin sektorit publik dhe atij privat. Masat janë planifikuar sipas sektorëve të aktivitetit, ku është adoptuar një qasje gjithëpërfshirëse e të gjithë sektorëve të aktiviteteve në territorin e bashkisë.

Natyrisht që sektorët kryesorë të shënjestruar janë: sektori i ndërtesave, ku janë përfshirë ndërtesat publike dhe private rezidenciale dhe tregtare, si dhe ndriçimi publik; sektori i transportit privat dhe publik urban. Gjithashtu, masat e planifikuara përfshijnë edhe sektorët jo-energjetik: bujqësinë, pyjet dhe përdorimet tjera të tokës; dhe menaxhimin e mbetjeve të ngurta bashkiake. Po ashtu ndër masat zbutëse janë paraparë edhe gjenerimi lokal i energjisë elektrike kryesisht nga energjia diellore, si dhe ngrohjes nga panelet diellore termike.

Plani i masave përshtatëse

Përshtatja ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike ka përfshirë masat në sektorët e aktivitetit të territorit të bashkisë që janë më të cenueshme ndaj ndryshimeve klimatike. Duke qenë se cenueshmëria e sektorëve mund të ndryshojë dukshëm ndërmjet perimetrit urban të territorit të bashkisë, nga zonat urbane dhe rurale, plani i masave përshtatëse ka përfshirë mjaft sektorë si: bujqësinë dhe pyjet, përdorimet tjera të tokës, ujërat dhe ujërat e zeza, biodiversitetin.

Plani i masave përshtatëse është mjaft fleksibël për të mundësuar që të integrojë edhe masa tjera në të ardhmen varësisht prej ndryshimeve klimatike dhe rrethanave tjera mjedisore.



2.3. Struktura dhe organizimi i Bashkisë

2.3.1. Organograma

Struktura organizative e Bashkisë Durrës përbëhet Kryetari dhe tre Nën kryetarë të cilët kanë në vartësi 12 Drejtori kryesore të saj.



Fig. 1: Paraqitja skematike e Struktures Organizative të Bashkisë

2.3.2. Njësitë përgjegjëse për zbatimin e SECAP

Sic shihet dhe nga figura, nën Kryetarët kanë në vartësi Drejtoritë kryesore, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre nëpërmjet sektorëve që mbulojnë aktivitetet bashkiake ngushtësisht të lidhura me shërbimet bazë të saj, dhe që do të jenë direkt përgjegjëse për planifikimin dhe monitorimin e masave që do të zbatohen në kuadër të planit të SECAP.



2.4 Metodologjia dhe Procesi i SECAP

2.4.1 Informacion i përgjithshëm rreth metodologjisë dhe përmbajtjes së SECAP

Plani i Veprimit për Energji e Qëndrueshme dhe Klimën është dokumenti kryesor me të cilin njësia e vetë-qeverisjes vendore – nënshkruese e Konventës së Krye-Bashkiakëve – përcakton strategjitë e duhura për të arritur objektivin e reduktimit të shkarkimeve të gazrave serë për së paku 40% deri në vitin 2030 krahasuar me vitin bazë.

SECAP-i përqendrohet në masat zbutëse dhe përshtatëse që Bashkia e Durrësit synon të ndërmarë, brenda kompetencave dhe përgjegjësi të veta; specifiku përcakton masat konkrete për reduktimin e shkarkimeve të gazrave serë dhe konsumit përfundimtar të energjisë, si dhe masat përshtatëse ndaj ndryshimeve klimatike.

Ky plan është hartuar në përputhje me Udhëzimet e CoM¹ për metodologjinë e hartimit dhe përmbajtjen e dokumentit; në këtë kuptim SECAP-i për Bashkinë e Durrësit përmban strategjitë dhe masat konkrete që planifikohen të ndërmerren në territorin e bashkisë, duke përfshirë sektorin publik dhe privat.

Udhëzuesi i CoM³ për hartimin e SECAP-it rekomandon që Plani i Veprimit të përmbajë këto pjesë kryesore:

- Vizionin dhe strategjinë afatgjatë, si dhe synimet kryesore strategjike energjetike dhe klimatike gjer në vitin 2030 dhe/ose më tutje, duke përfshirë zotimet në fushat specifike të aktiviteteve;
- Vlerësimin e situatës ekzistuese në kuptim të vlerësimit të konsumit final të energjisë dhe shkarkimeve të gazrave serë, si dhe vlerësimin e rreziqeve dhe cenueshmërisë nga ndryshimet klimatike – vlerësim ky që adresohet përmes Inventarit Bazë të Shkarkimeve (*BEI – Baseline Emission Inventory*) dhe Vlerësimi i Riskut dhe Cenueshmërisë (*RVA-Risk and Vulnerability Assessment*);
- Politikat dhe masat specifike zbutëse dhe përshtatëse për periudhën e planifikuar që paraqesin veprimet konkrete për arritjen e qëllimeve strategjike afatgjate, si dhe mënyrën e financimit të këtyre masave.

Në përputhje me Udhëzimet e CoM, SECAP për Bashkinë e Durrësit përmban pjesët kryesore si në vijim:

- Strategjinë afatgjatë e cila përmban vizionin me zotimin e qartë për arritjen e objektivave të reduktimit të shkarkimeve të gazrave serë, përmes masave zbutëse dhe adaptuese, alokimin e burimeve njerëzore dhe financiare për zbatimin e masave, si dhe përfshirjen e palëve të interesit dhe qytetarëve.



³ Guidebook 'How to develop a Sustainable Energy and Climate Action Plan (SECAP)', Science for Policy report by the Joint Research Centre (JRC), 2018. <https://eu-mayors.ec.europa.eu/en/resources/reporting>

- Inventarin Bazë të Shkarkimeve (BEI) me rezultatet e konsumit final të energjisë dhe shkarkimeve përkatëse të CO₂ / CO₂ ekuivalent në vitin referent sipas sektorëve të aktivitetit dhe energjentëve, e shoqëruar me analizat përkatëse.
- Vlerësimin e Riskut dhe Cenueshmërisë (RVA), ku paraqiten vlerësimet për rreziqet dhe cenueshmëritë ndaj ndryshime klimatike, si dhe vlerësimi i ndikimit të tyre në jetën dhe pronën qytetarëve, si dhe në sektorët e aktiviteteve socio-ekonomikë.
- Planin e veprimit me detajet e masave të planifikuara për arritjen e objektivave strategjike të energjisë dhe klimës, si dhe niveleve të reduktimit të shkarkimeve; specifikisht:
 - Masat zbutëse – përshkrim i detajuar i masave të veçanta, afatet kohore të zbatimit, përgjegjësinë e zbatimit, kostot përkatëse të investimit dhe ndarjet buxhetore respektivisht mënyrën e financimit, si dhe ndikimin e para-vlerësuar;
 - Masat përshtatëse – përshkrimin e detajuar të masave, afatet kohore dhe përgjegjësitë në zbatim, si dhe kostot e zbatimit dhe mënyrat e financimit;
- Planifikimin financiar – identifikimi i mënyrave të financimit dhe detajet e financimit sipas afateve kohore të zbatimit.

2.4.2 Procesi i SECAP

Procesi i tërësishëm i zhvillimit të SECAP-it përfshin dy kategori kryesore procesesh:

- Procesi i përgatitjes së SECAP-it; dhe
- Procesi i zbatimit dhe monitorimit të SECAP-it

Procesi i hartimit të SECAP, përfshin disa faza si: përgatitore, vlerësimin e situatës ekzistuese, planifikimin, dhe monitorimin e raportimin – në vijim paraqitet skematikisht:






Figura 2: Hapat e zhvillimit të SECAP-it

2.4.3 Fazat përgatitore

Përgatitja e SECAP-it ka kaluar nëpër disa faza të kategorizuara kryesisht në fazën e përgatitore, vlerësimit të situatës ekzistuese dhe të planifikimit.

- **Faza e përgatitore** – aktivitetet si në vijim:

- Aderimi në Konventën e Krye-bashkiakëve (CoM): Vendimmarrja politike dhe zotimi fillestar për të qenë pjesë e CoM duke marrë përsipër detyrimet dhe përgjegjësitë përkatëse; nënshkrimi zyrtarë i Konventës; dhe Informimi i administratës dhe palëve të interesit për fillimin e procesit të zhvillimit të SECAP-it.
- Përfshirja dhe mobilizimin e administratës së Bashkisë: Përcaktimi dhe mobilizimi i departamenteve të bashkësisë; alokimi i kapaciteteve njerëzore profesionale të mjaftueshme për zhvillimin e SECAP-it; dhe organizimi struktural i ekipit përfshirë edhe emërimin e koordinitorit(es) dhe përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësisë;
- Sigurimi i pjesëmarrjes së palëve të interesit dhe qytetarëve: Informimi e dhuror për procesin e hartimit të SECAP-it; përcaktimi se cilët palë duhet të përfshihen dhe në cilat fusha; dhe përcaktimi i mënyrave të pjesëmarrjes dhe nivelit të angazhimit të palëve.

- **Faza e vlerësimit të situatës ekzistuese** – aktivitetet si në vijim:



- Përgatitja e Inventarit Bazë të Shkarkimeve (BEI): Përcaktimi i konsumit final të energjisë, dhe shkarkimeve përkatëse të gazrave serë, sipas energjentëve dhe sektorëve të aktivitetit.
- Përgatitja e Vlerësimit të Rrezikut dhe Cenueshmërisë (RVA): Vlerësim gjithëpërfshirës i rreziqeve dhe cenueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike.
- **Faza e Planifikimit / Hartimi dhe aprovimi i SECAP – ka ndërthurur aktivitetet vijuese:**
 - Hartimi i strategjisë dhe vizionit: Përcaktimi i objektivave kryesore strategjike dhe vizionit mjaftueshëm ambicioz për përmbushjen e zotimeve ndaj CoM;
 - Hartimi i planit të veprimit: Përcaktimi i politikave dhe masave (zbutëse dhe përshtatëse) në përputhje me vizionin dhe objektivat strategjike; definimi i kostos financiare, burimeve dhe mekanizmave të financimit; specifikimi i afateve kohore të zbatimit të masave dhe indikatorëve përkatës; dhe përcaktimi i përgjegjësisë në zbatimin e masave (përfshirë strukturat bashkiake dhe qeverisë qendrore), si dhe partnerëve tjerë në zbatim.
 - Konsultimi publik: Përfshirja e palëve të interesit dhe publikut të gjerë përmes konsultimit dhe dhënies së vërejtjeve, sugjerimeve dhe inputeve për finalizimin e Planit.
 - Aprovimi dhe dorëzimi i Planit: Aprovimi i planit në Këshillin Bashkiak dhe dorëzimi i Planit përmes web-faqes së CoM.

2.4.4 Zbatimi dhe monitorimi i procesit

Në përputhje me dispozitat e CoM, duhet të raportohet çdo dy vjet për zbatimin e SECAP-it përmes platformës 'MyCovenant'; raportimi duhet të kryhet sipas Udhëzuesit për Raportim të CoM. Me qëllim lehtësimin e procesit të zbatimit dhe monitorimit të zbatimit të masave, bashkive nënshkruese ju është mundësuar shfrytëzimi i kornizës për mbledhjen e të dhënave të raportimit⁴.

Raportimi dhe monitorimi i të dhënave të Planit të veprimit bëhet sipas së ashtuquajturës 'Formulari i SECAP' (angl. 'SECAP Template'), prej nga bashkive nënshkruese të konventës ju mundësohet të demonstrojnë ndikimin konkret të masave të ndërmarra në përmbushjen e objektivave energjetike dhe klimatike. Njëkohësisht bashkive ju mundësohet mbledhja dhe analizimi i të dhënave në mënyrë të sistematike dhe të strukturuar, që ju shërben si bazë solide për menaxhimin e energjisë dhe klimës së bashkisë së tyre dhe të përcjellin progresin në fazën e zbatimit.

Faza e zbatimit të masave

Faza e zbatimit është faza me kohëzgjatjen më të madhe (tërë periudha e planifikimit në SECAP) dhe që kërkon përkrahjen politike institucionale, angazhimin e kapaciteteve të mjaftueshme profesionale dhe burime konsiderueshme financiare. Gjatë fazës së zbatimit është thelbësore të vendoset bashkëpunimi dhe komunikimi intern mes departamenteve dhe zyrtarëve të bashkisë,



⁴ <https://www.globalcovenantofmayors.org/our-initiatives/data4cities/common-global-reporting-framework/>

si dhe komunikimi i jashtëm me palët e interesit dhe qytetarët, me qëllim të vetëdijesimit, ndryshimit të sjelljes, dhe sigurimit të përkrahjes së gjerë në procesin e zbatimit të SECAP-it.

Gjatë fazës së zbatimit Bashkia do të ndërmarrë aktivitetet në vijim:

- Të vazhdojë përkrahjen politike afatgjatë për zbatimin e SECAP-it dhe të motivojë palët e interesit dhe qytetarët të përkrahin dhe të bëhen pjesë e zbatimit të këtij plani veprimi;
- Të sigurojë që politikat energjetike dhe klimës përfshirë edhe zbatimin e masave konkrete të integrohen në punën dhe menaxhimin e përditshëm të administratës vendore;
- Të koordinojë pjesëmarrjen dhe të specifikojnë rolin e palëve partnere dhe qytetarëve në zbatimin e masave;
- Të zbatojë me përpikëri masat që janë në përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të bashkisë, duke treguar shembuj të mirë;
- Të nxisë palët e interesit dhe qytetarët të jenë partnerë aktiv në zbatimin e masave;
- Të vendosë bashkëpunim përmbajtësor me bashkitë tjera aderuese në CoM, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më mira, dhe duke krijuar sinergji në zbatimin e masave të SECAP-it.

Faza e monitorimit dhe raportimit

Monitorimi është një pjesë e rëndësishme e procesit të SECAP-it; monitorimi i rregullt i shoqëruar me korrigjimet e duhura të planit mundësojnë përmirësimin e vazhdueshëm të procesit dhe zbatimin në kohë të masave.

Siç u përmend më lartë bashkitë nënshkruese detyrohen të përgatisin dhe dorëzojnë Raportin e Monitorimit çdo dy vjet, me qëllim vlerësimin, monitorimin dhe verifikimin e zbatimit të masave të SECAP-it. Ky raport duhet të përmbajë këto të dhëna:

- Të dhëna dhe informata sasiore mbi zbatimin e masave të SECAP-it, përfshirë statusin e zbatimit të secilës masë dhe pengesat e hasura në zbatim;
- Inventarin e përditësuar të monitorimit të shkarkimeve (*MEI – Monitoring Emission Inventory*), të hartuar sipas të njëjtës strukturë metodë dhe burim të të dhënave të Inventarit Bazë – BEI.

Në fazën e monitorimit bashkia do të ndërmarrë aktivitetet e përshkruara si më poshtë:

- Krijimi i sistemit të mbledhjes së rregullt periodik të informacionit dhe të dhënave mbi progresin e zbatimit të SECAP-it;
- Vlerësimi i ndikimit të zbatimit të secilës masë të planifikuar në SECAP;
- Përgatitja e Raportit të monitorimit, në përmbajtje dhe strukturë sipas udhëzimeve përkatëse të CoM, si dhe dorëzimi përmes web-platformës së CoM;
- Komunikimi i rezultateve të monitorimit të progresit në zbatimin e SECAP-it autoriteteve vendimmarrëse, aktorëve të përfshirë dhe qytetarëve.



Në vijim paraqiten në formë tabelare fazat dhe kërkesat për raportim ndaj CoM

Tabela 1: Kërkesat minimale të raportimit në web-platformën e COM

	Regjistrimi	Plani Veprimit SECAP	Monitorimi Raportimi akcional	Monitorimi Raportimi i plotë
	Viti zero	Brenda 2 viteve	Brenda 4 viteve	Brenda 6 viteve
Strategjia – vizioni dhe objektivat kyç	0	✓	✓	✓
Plani i veprimit – përditësimi i dokumentit	0	✓	0	0
Inventari i shkarkimeve	0	✓ (BEI)	0	✓ (MEI)
Vlerësimi i rrezikut dhe cenueshmërisë	0	✓	✓	✓
Masat zbutëse	0	(min. 3 masa kryesore)	✓	✓
Masat përshtatëse	0	0	(min. 3 masa kryesore)	✓
Masat e varfërisë energjetike	0	0	(min. 1 masë kryesore)	✓

2.5. Kuadri ligjor për zhvillimin e SECAP

2.5.1. Në nivel të Bashkimit Evropian

Plani i Gjellbër Evropian përfaqëson një paketë nismash me synimin bazë për një transformim të gjelbër të BE-së, me qëllimin përfundimtar arritjen e neutralitetit klimatik deri në vitin 2050. Kuadri legjislativ shoqërues brenda të cilit janë përcaktuar ligjërisht qëllimet përfshin, mbi të gjitha, Ligji i BE-së për Klimën. Me miratimin e këtij ligji, BE-ja dhe shtetet e saj anëtare u angazhuan për të reduktuar shkarkimet neto të gazeve serrë të BE-së me të paktën 55% krahasuar me nivelet e vitit 1990 deri në vitin 2030. Në fillim të vitit 2024, Komisioni Evropian rekomandon objektiva të reja, më ambicioze në rrugën e arritjes së neutralitetit klimatik, që nënkupton një reduktim të shkarkimeve neto të gazeve serrë me 90% deri në vitin 2040 krahasuar me nivelet e vitit 1990.

Objektivat në nivelin Bashkimit Evropian (EU) dhe të Komunitetit të Energjisë (EnC)

Plani i Gjellbër Evropian ka vendosur objektiva mjaft ambicioze deri në vitin 2030 në tre komponentë kryesore:

- Reduktimin e shkarkimeve të gazeve serë për së paku 55% krahasuar me nivelet e shkarkimeve në vitin referues 1990;



- Eficienca e energjisë – reduktimi i konsumit final të energjisë në së paku 11.7% krahasuar me projeksionet e konsumit për vitin 2030;
- Pjesëmarrja e energjisë nga Burimet e Rinovueshme të Energjisë minimum 42.5% e konsumit final të energjisë.

Duke qenë se Shqipëria është anëtare e Komunitetit të Energjisë që përfshin rajonin e Evropës Juglindore, në vijim janë dhënë objektivat në nivel të EnC për vitin 2030 për tre komponentët kryesorë:

- Reduktimi i shkarkimeve të gazrave serë (CO₂ dhe CO₂ ekuivalent) 60.9% krahasuar me vitin referues 1990;
- Eficienca e energjisë - Konsumi maksimal e konsumit të energjisë primare 129.88 Mtoe, dhe konsumi final maksimal i energjisë 79.06 Mkttoe;

Pjesëmarrja e energjisë nga Burimet e Rinovueshme të Energjisë minimum 31% të konsumit final të energjisë.

2.5.2. Në nivel kombëtar

Disa nga dokumentet ligjore në nivel vendi janë:

- VKM 742.2015 Për funksionimin dhe menaxhimin e regjistrit të shkarkimit e të transferimit të ndotësve, miratimin e listës së veprimtarive dhe të ndotësve, që janë subjekt i këtij regjistri;
- Ligji Nr.10 476, datë 3.11.2011 "Për Aderimin e RSH në Protokollin e Konventës së vitit 1979 "Për ndotjen Ndërkufitare të Ajrit në Distançë të Largët për të Pakësuar Acidifikimin, Eutrofikimin dhe Ozonin në Shtresën e Poshtme të Atmosferës";
- Ligj 10463.2011, "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve";
- Ligj 10448, "Për Lejet e Mjedisit, i Përditësuar";
- Ligj 10440, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", i përditësuar;
- Ligj 10431.2011, "Për Mbrojtjen e Mjedisit";
- Ligj 9587.2006, "Për Mbrojtjen e Biodiversitetit", i përditësuar;
- Ligj 8897.2002, "Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja";
- Ligj 162.2014, "Për Mbrojtjen e Cilësisë së Ajrit në Mjedis";
- Ligj 155.2020, "Për Ndryshimet Klimatike";
- Ligj 111.2012, "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore";
- Ligj 28.2013, "Për Disa Ndryshime dhe Shtesa në ligjin nr.8897.2002 Për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja";
- Vendimi Nr. 633, datë 26.10.2018 "Për Masat Kundër Ndotjes së Ajrit nga Shkarkimet e Mjeteve Motorike dhe Reduktimin e Shkarkimeve në Ajër të Ndotësve të Gaztë dhe të Lëndës së Ngurtë Pezull nga Motorët me djegie dhe ata me djegie me Kompresorë që Djegin Gaz Natyror apo të Lëngshëm për Përdorim në Automjete";



- VKM 633.2018, "Për Masat Kundër Ndotjes së Ajrit nga Shkarkimet e Mjeteve Motorike dhe Reduktimin e Shkarkimeve në ajër";
- VKM 575.2015, "Për Menaxhimin e mbetjeve të ngurta";
- VKM 505.2018, "Për Miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Heqjen nga Përdorimi dhe Eliminimin e Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm (NOQ)";
- VKM 418.2014, "Për Grumbullimin e Diferencuar të Mbetjeve në Burim";
- VKM 412.2019, "Për Miratimin e Planit Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit";
- VKM 360.2015, "Për Miratimin e Listës së Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm dhe Përcaktimin e Masave për Prodhimin, Importimin, Vendosjen në Treg dhe Përdorimin e Tyre".

Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës i Republikës së Shqipërisë përcakton gjithashtu objektiva mjaft ambicioze për tre komponentët kryesorë:

- Reduktimi i shkarkimeve të gazrave serë (me masa shtesë) në nivelin 18.7% krahasuar me masat ekzistuese;
- Eficienca e energjisë – reduktim i konsumit final të energjisë (me masa shtesë) për 8.4% krahasuar me masat ekzistuese;

Pjesëmarrja e energjisë nga Burimet e Rinovueshme të Energjisë minimum 54.4 % të konsumit final të energjisë.

2.5.3. Në nivel rajonal

Axhenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor është një strategji e re e rritjes për rajonin, duke kaluar nga një model ekonomik tradicional në një ekonomi të qëndrueshme, në përputhje me Marrëveshjen e Gjellbër Evropiane. Ai është i përfshirë në Planin Ekonomik dhe Investimeve për Ballkanin Perëndimor⁵. Agjenda e Gjellbërt identifikon pesë shtylla kryesore:

- i. veprimin klimatik;
- ii. ekonominë qarkulluese, trajtimin e mbetjeve, riciklimin, prodhimin e qëndrueshëm, përdorimin efikas të burimeve;
- iii. biodiversitetin, duke synuar mbrojtjen dhe rivendosjen e pasurisë natyrore të rajonit;
- iv. luftën ndaj ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës dhe
- v. sistemet e qëndrueshme të ushqimit dhe zonat rurale.

2.5.4. Në nivel vendor

Ne nivel vendor mund të përmendim:

- Ligji 10/431 – Për Mbrojtjen e Mjedisit;
- Ligji 111/2012 – Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore;



⁵ Komisioni Evropian - Udhëzime për Zbatimin e Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, SWD(2020) 223 final

- VKM nr.1015 dt.16.12.2020 për Përmbajtjen, Zhvillimin dhe Zbatimin e Strategjive Kombëtare të Ujit, të Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore dhe të Planeve të Menaxhimit të Rrezikut nga Përmbajtjet;
- VKM Nr. 623, datë 8.11.2023 "Për Miratimin e Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Erzen 2024–2029;
- VKM Nr. 624, datë 8.11.2023, "Për Miratimin e Planit të Menaxhimit të Basenit Ujor Ishëm 2024–2029;
- Vendimi KKT Nr. 4, datë 27.7.2022 "Plani i Zhvillimit dhe Rregullorja e Bashkisë Durrës"

2.6. Përfshirja e aktorëve

Me qëllim përgatitjen dhe përzgjedhjen e masave prioritare për të reduktuar ndikimin në ndryshimet klimatike dhe aktivitetet e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në territorin e qytetit të Durrësit, të cilat rezultojnë nga analizat e zhvilluara BEI dhe RVA, dhe planet strategjike në nivel vendor, si dhe nga konsultimet, procesi është realizuar me të gjithë aktorët e Bashkisë së Durrësit, anëtarë të grupit të punës të SECAP përfshirë dhe pjesë të shoqërisë civile.

Përmes procesit të konsultimit, u mundësua një pasqyrë e ndikimeve të pritshme të ndryshimeve klimatike në territorin e qytetit, me qëllim hartimin e masave të duhura dhe të nevojshme për të reduktuar ndikimin e ndryshimeve klimatike dhe masat për t'iu përshtatur ndryshimeve klimatike dhe të kontribuojë në krijimin e dokumentit SECAP. Pas përcaktimit dhe prioritizimit të masave të propozuara nga grupi i punës u morën parasysh për të përcaktuar prioritetet e propozuara, të cilat u paraqitën gjatë përcaktimit të listën përfundimtare të masave prioritare.

2.7. Procesi i Monitorimit dhe Vlerësimit

Në përputhje me Paktin e Kryetarëve të Bashkive, është e nevojshme të raportohet për zbatimin e SECAP çdo dy vjet përmes platformës MyCovenant, në përputhje me Udhëzimet për Raportimin e Paktit të Kryetarëve të Bashkive. Për të lehtësuar zbatimin e këtij procesi dhe monitorimin e zbatimit të tij, nënshkruesve u mundësohet përdorimi i kornizës së mbledhjes dhe raportimit të të dhënave.

Të dhënat e raportuara u lejojnë nënshkruesve të demonstrojnë ndikimin konkret të veprimeve të tyre në terren dhe ambiciet e tyre klimatike. Ai ofron komente thelbësore mbi aktivitetet vendore për politikëbërësit në nivel kombëtar, evropian dhe ndërkombëtar. Marrëveshja kuadër u mundëson nënshkruesve të mbledhin dhe analizojnë të dhënat në mënyrë të strukturuar dhe sistematike dhe shërben si bazë për menaxhimin e mirë të klimës dhe energjisë dhe për monitorimin e progresit në zbatim.

Ky dokument ofron udhëzime hap pas hapi për nënshkruesit se si të raportojnë informacionin në seksionet e ndryshme të platformës së raportimit të platformës MyCovenant. Ai u zhvillua nga Zyra e Paktit Evropian të Kryetarëve të Bashkive në bashkëpunim me JRC për të ndihmuar



nënshkruesit të kuptojnë kornizën e raportimit në Platformë dhe të përfundojnë me sukses procesin e raportimit.

Autoritetet vendore që i bashkohen nismës së Marrëveshjes së Kryetarëve të Bashkive për Klimën dhe Energjinë marrin përsipër të paraqesin një plan veprimi / SECAP brenda dy viteve nga nënshkrimi formal i nismës (nëpërmjet një formulari të anëtarësimit).

Plani i Veprimit / SECAP përcakton qëllimet e zbutjes dhe objektivat e përshtatjes dhe bazohet në Inventarin Bazë të Emisioneve (BEI) dhe Analizën e Rrezikut Klimatik dhe Vlerësimin e Cenueshmërisë të Sektorëve Individualë (RVA), të cilat ofrojnë një analizë të situatës aktuale në një kohë të caktuar. Ato shërbejnë si bazë për përcaktimin e një grupi gjithëpërfshirës veprimesh që autoritetet vendore planifikojnë të ndërmarrin për të arritur qëllimet e zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.

2.8. Të dhëna rreth Bashkisë Durrës

Durrësi është qyteti me aktivitetin më të madh ekonomik pas Tiranës, por urbanizmi i shpejtë dhe pa kriter ka krijuar një varg problemesh që pengojnë zhvillimin e qëndrueshëm.

Zona Gjeografike: Bashkia Durrës kufizohet në perëndim me Detin Adriatik, në veri me bashkinë Kurbin, në lindje me bashkitë Krujë, Vorë e Shijak dhe në jug me bashkinë Kavajë.

Kjo bashki përbëhet nga gjashtë njësi administrative, të cilat janë: Durrësi, Sukthi, Ishmi, Katundi i Ri, Rrashbulli dhe Manëz. Të gjitha njësitë e bashkisë së re bëjnë pjesë në rrethin Durrës, qarku Durrës. Në territorin e bashkisë së re gjenden tre qytete, Durrës, Sukth dhe Manëz, si dhe 39 fshatra të tjerë.

Popullsia: Sipas censusit të vitit 2011, në territorin e bashkisë së re Durrës banojnë 175,110 vetë ndërsa sipas regjistrit civil popullsia rezidente është 299,989 vetë. Me një sipërfaqe prej 338.30 kilometrash katrorë, densiteti i popullsisë sipas të dhënave të Censusit 2011 është 517 banorë km², ndërsa sipas Regjistrit Civil është 680 banorë km²

Qarku	Qendra e Bashkisë	Njësitë administrative përbërëse	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre	Popullsia sipas Census 2011	Popullsia sipas Regjistrit Civil	Sipërfaqja KM ²
Durrës	Qyteti Durrës	Durrës	Qyteti Durrës	175,110	299,989	338.3
		Sukth	Qyteti Sukth, Fshatrat; Hamallaj, Kullë, Perlat, Vadardhë, Rushkull, Hidrovori			
		Ishëm	Fshatrat; Likmetaj, Kërtushaj, Kapidanaj, Gjericaj, Lalëz, Kuraten, Bizë, Draç, Shetaj,			
		Katundi i ri	Fshatrat; Katundi i ri, Jubë, Qerret, Fllakë, Bisht-Kamëz, Rinia, Erzen, Sukth, Adriatik			
		Rrashbull	Fshatrat; Rrashbull, Arapaj, Shënavlash, Shkallnur, Manskuri, Romanat, Bozanxhije, Xhafzotaj,			
		Manëz	Qyteti Manëz, Fshatrat; Armath, Borç, Hamallaj, Kameronas, Rade, Shkallë, Fshat Manëz			

Tabela 2: Popullsia e qytetit Durrës sipas njësive të saj administrative.



Sic shihet dhe nga tabela më sipër ajo që vihet re është rritja në përgjithësi me ritme konstante e popullësisë për shkak të lëvizjeve demografike, por rritja është më e ndjeshme në zonën urbane, një tendencë kjo e vërejtur pothuaj në të gjitha bashkitë e vendit.

2.8.1. Vlerësimi i mundësive për përshtatjen

Sic u përmend edhe në objektivat strategjike, zhvillimi ekonomik i bashkisë Durrës përqëndrohet kryesisht nga zhvillime që ofrohen nga vitalizimi, ri-kualifikimi i zonave ekonomike/industrial/portuale si dhe nga kryerja e investimeve madhore në infrastrukturën rrugore/ hekurudhore dhe detare. Zhvillimi ekonomik do të bazohet në nxitjen e nismave të investitorëve të huaj dhe vendas për hapjen e bizneseve të reja, promovimin e hapjes së sektorëve të rinj që ofrojnë shërbime si dhe nxitjes së sektorit turistik, bujqësor dhe transportit.

Zona është veçanërisht e ndjeshme ndaj përmbytjeve dhe erozionit të tokës sidomos në pjesën bregdetare, për shkak të degradimit të pyjeve keq përdorimit dhe shfrytëzimit të inerteve lumore në Ishëm dhe Erzen, ndërtimeve pa kriter etj. Intensiteti dhe shfaqja e këtyre ngjarjeve, si dhe ndikimet e tyre në jetesën dhe infrastrukturën, janë përkeqësuar më tej si rrjedhojë edhe e ndryshimeve klimatike.

Degradimi i peizazheve pyjore rezulton në efekte të dukshme, si toka të thata dhe jopjellore, rrëshqitje dheu, përmbytje dhe humbje të biodiversitetit. Kjo nga ana tjetër pakëson shërbimet e ekosistemit të pyjeve, duke përfshirë gjenerimin e oksigjenit dhe kapjen e karbonit, strehimin e habitateve për biodiversitetin dhe gjenerimin e burimeve natyrore të ardhurave për komunitetet vendore.

Për rrjedhojë, këto sfida mjedisore kanë ndikime të rëndësishme në jetesën, infrastrukturën dhe biodiversitetin në territorin e Bashkisë Durrës.

Referuar problematikave të mësipërme si dhe kushteve të kësaj bashkie, disa nga masat adaptuese janë:

- Zhvillimin e strategjisë ekonomike vendore;
- Reduktimi i mjeteve motorike me përdorim lënde fosile/karburanti;
- Shtimi i sipërfaqeve pyjore;
- Shtimin e sipërfaqeve të gjelbërta urbane;
- Mbrojtja e lumenjve Ishëm dhe Erzen nga përdorimi pa kriter i inerteve, si dhe ndërtimeve në afërsi të shtretërve të tyre;
- Reduktimin e shkarkimeve të lëngshme ndotëse në lumenjtë Ishëm dhe Erzen nga aktivitetet industriale që ndodhen pranë tyre.



2.8.2. Adresimi i situatave ekstreme të klimës

Nga raportet e mëparëshme realizuar në kuadër të përgatitjes së SECAP për Bashkinë Durrës, dhe takimeve tematike për këtë proces, ndikimi më i shpeshtë lidhur me efektet e ndryshimeve klimatike janë përmytjet.

Bashkia e Durrësit ndodhet në një zonë të ndjeshme rreziqesh natyrore. E ndodhur mes ujrave dhe mbi ujra – deti në perëndim me lumenjtë që e përshkojnë si dhe niveli i lartë i ujrave nën tokësore dhe në një terren kodrinor të rrëshqitshëm, Durrësi është gjithashtu subjekt i erërave dhe qendër e lëkundjeve sizmike në vend. Ndryshimet klimatike dhe çrregullimi i motit me shira të shkurter, por të rrembyeshëm dhe veprimi shkatërrues i njerëzve në dy dekadat e fundit në basenet ujë-mbledhëse dhe në shtretërit e lumenjve, e bëjnë të domosdoshëm marrjen parasysh të rreziqeve natyrore në planet e zhvillimit urban të Bashkisë Durrës.




Fig. 3: Harta e zonave potencialisht të përmytëshme.

I gjithë korridori përgjatë lumit Erzen, duke filluar nga pjesa perëndimore e kodrave të Shijakut dhe duke vazhduar duke u zgjeruar gradualisht në grykë-derdhjen e lumit, rrezikohet nga fenomeni i përmytjeve periodike. Kjo zonë përkon edhe me një korridor urban të populluar mes Rrashbullit, Sukthit, Katundit të Ri, dhe Rrushkull, që është dhe poli i dytë urban nga rëndësia në Bashkinë e re. Përmytjet e Janarit 2016 në Sukth dhe KiR konfirmojnë rëndësinë e këtij problemi.

Sipas një komunikate të Ministrisë së Bujqësisë, datë 7 janar 2015 janë përmytur në Rrashbull 40 hektarë, në Sukth 25 hektarë, në Ishëm 200 hektarë, (përfshirë dhe një sasi toke të papërcaktuar në Gjericaj).

Harta e zonës potenciale të përmytjeve të lumit Erzen, e evidentuar me ngjyrë të kaltër⁶.

- Hartimi i procesverballi të vlerësimit të gjendjes;

⁶ Burimi Shërbimi Gjeologjik Shqiptar – Harta e Rrezikut Gjeologjik Shqiptar



- Evidentimi i dëmtimit të ndërtesave të banimit, si dhe dëmtimeve të aktiviteteve ekonomike, përfshirë mjete dhe pajisjet, etj.
- Verifikimi dhe konfirmimi i situatës nga struktura vendore të Mbrojtjes Civile;
- Mbledhja e Këshillit Bashkiak për ndërhyrjet e kërkuar shoqëruar me buxhetin përkatës



3 Inventari Bazë i Shkarkimeve (BEI)

3.1 Hyrje

Nisur nga fakti se, objektivi kryesor i Planit të Veprimit për Energji të Qëndrueshme dhe Klimën (SECAP) është përcaktimi i objektivave të reduktimit të shkarkimeve të CO₂ në territorin e Bashkisë Durrës deri në vitin 2030, është me rëndësi mbledhja e të dhënave cilësore mbi konsumin e energjisë dhe shkarkimeve të gazrave serë për vitin bazë – viti referent ndaj së cilit llogaritet reduktimi i shkarkimeve.

Inventari bazë i shkarkimeve të gazrave serë (me fokus CO₂) paraqet vlerat sasiore të shkarkimeve në vitin referent, si rezultat i konsumit të energjisë dhe aktiviteteve tjera brenda territorit të bashkisë. Në bazë të këtij inventarizimi përcaktohen prioritetet në drejtim të reduktimit të shkarkimeve, dhe për këtë inventari bazë konsiderohet si mjet kryesorë në planifikimin e suksesshëm të masave të efijencës së energjisë dhe masave tjera 'jo-energjetike' me ndikim në reduktimin e shkarkimeve të CO₂.

Në këtë kuptim BEI, së bashku me RVA, përbëjnë bazën dhe pikën fillestare të procesit të hartimit të SECAP-it dhe është pjesë përbërëse e këtij plani. Prandaj në vijim paraqiten të përmbledhura rezultatet kryesore të konsumit të energjisë dhe shkarkimeve të CO₂, sipas sektorëve të aktivitetit të identifikuar në Bashkinë e Durrësit, të shoqëruara me analizat përkatëse.

3.2 Metodologjia dhe qasja e hartimit të BEI

Përgjithësisht BEI i është përmbajtur opsioneve metodologjike të Udhëzimeve të Konventës së Kryebashkiakëve (CoM – Covenant of Mayors); gjithashtu komponentët e veçanta të BEI janë hartuar në përputhje me udhëzimet e dhe metodologjitë e përshkruara në Protokollin Global të Inventarëve të Shkarkimeve të Gazrave Serë në Nivel-Komuniteti (GPC - Global Protocol for Community-Scale Greenhouse Gas Emission Inventories), dhe Protokollit të Panelit Ndërqeveritar për Ndryshime Klimatike (IPCC – Intergovernmental Panel on Climate Change).

Kategorizimi i shkarkimeve dhe llojet e gazrave serë të inventarizuar

Duke ju përmbajtur qasjes së 'bazuar-në-aktivitet', në inventarizim janë përfshirë tre format e shkarkimeve:

- shkarkime direkte nga konsumi final i energjisë;
- shkarkimet indirekte nga konsumi energjisë nga rrjeti (energji elektrike, ngrohja ftohta); dhe
- shkarkimet jo të ndërlidhura me energjinë.

Janë inventarizuar tre përbërësit kryesorë të gazrave serë:

- Dioksidi karbonit (CO₂); dhe



- Oksidi i azotit (N₂O) dhe metani (CH₄) për të cilat sasitë e shkarkuara janë ekuivalentuar me 'ton CO₂ ekuivalent'

Sektorët e aktivitetit

Në përputhje me Udhëzuesin CoM dhe me qasjen e përzgjedhur 'bazuar-në aktivitet', BEI për Durrës përmban makro-sektorët energjetikë dhe jo-energjetikë, specifikisht:

- i) Makro-sektori ndërtesave;
 - ii) Transporti;
 - iii) Mbetjet; dhe
 - iv) Bujqësia dhe Pylltaria.
- Sektori i ndërtesave pajisjeve dhe impianteve (shkurtimeisht 'Ndërtesat') i ndarë në nën-sektorët:
 - Ndërtesat publike / bashkiake;
 - Ndërtesat private të banimit dhe komerciale; dhe
 - Ndriçimi publik.
 - Sektori i transportit (vetëm transporti rrugor):
 - Flota e automjeteve bashkiake
 - Transporti publik;
 - Transporti privat individual dhe biznesit; dhe
 - Dy sektorët 'jo-energjetikë':
 - Sektori i mbetjeve – mbetjet e ngurta bashkiake; dhe
 - Sektori i bujqësisë, pyjet dhe përdorimet tjera të tokës

Metoda e llogaritjes së shkarkimeve

Për sektorët energjetikë, shkarkimet direkte dhe indirekte të gazrave serë janë llogaritur për aktivitetet specifike bazuar në konsumin final të energjisë dhe faktorin korrespondues të shkarkimeve:

- Shkarkimet direkte për sektorin e ndërtesave janë llogaritur nga të dhëna e konsumit të energjisë: energjia elektrike, LPG, dizeli, biomasa dhe ngrohja me energji diellore, dhe faktorët respektiv të shkarkimit;
- Në mënyrë të ngjashme janë llogaritur shkarkimet për transportin nga konsumi i karburantit: dizeli e benzina, dhe faktorët përkatës të shkarkimeve.

Për aktivitetet jo të lidhura me energjinë (sektori i mbetjeve dhe bujqësia e blegtoria) shkarkimet janë llogaritur në përputhje me Udhëzimet e IPCC 2006.

Viti bazë referues



Për BEI Durrës është marrë viti bazë 2015; kjo për faktin se, në vitin 2015 ka përfunduar reforma e ndarjes territoriale në Shqipëri përmes së cilës janë përcaktuar kufijtë administrative dhe territoret respektive të bashkive, dhe të dhënat e nevojshme përpara këtij viti nuk janë transferuar dhe agreguar sipas përbërjes së re administrative të njësive të qeverisjes vendore.

Me qëllim të besueshmërisë dhe korrektësisë së të dhënave dhe mbledhjes së tyre nga të gjitha njësitë administrative, me arsye është vendosur që 2015 të jetë viti referues, vit në të cilin ka filluar raportimi nga të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Durrës.

3.2 Analiza e konsumit të energjisë dhe shkarkimeve të gazrave serë sipas sektorëve

Në përputhje me ndarjen e aktiviteteve sektoriale të përshkruar më lartë, në vijim jepet analiza për shpenzimin e energjisë dhe shkarkimet sipas sektorëve të aktivitetit.

3.2.1 Analiza për sektorin e ndërtesave pajisjeve dhe impianteve ('Ndërtesat')

Konsumi i energjisë

Në sektorin e Ndërtesave, energjia elektrike është komponentja kryesore e konsumit të energjisë, e pasuar në masë shumë më të vogël nga lëndët djegëse fosile: nafta dhe gazi i lëngshëm, si dhe biomasa dhe ngrohja diellore.

Në tabelën vijuese janë paraqitur sasitë e konsumit të energjisë sipas nën-sektorëve.

Tab.3: Konsumi i energjisë për sektorin e ndërtesave

Sektori i Ndërtesave - Konsumi i energjisë [MWh/vit]						
Nënsektorët	Energji elektrike	Gaz i lëngshëm	Naftë / Dizel	Biomasa	Ngrohje diellore	Total
Ndërtesat publike bashkiake	845.00	18.05	54.70	64.00	50.00	1,031.75
Ndërtesat private të banimit	185,600.50	2,400.00	3,120.00	450.00	560.00	192,130.50
Ndërtesat private afariste	43,560.00	0.00	0.00	0.00	0.00	43,560.00
Ndriçimi publik	11,300.00	0.00	0.00	0.00	0.00	11,300.00
Total Sektori	241,305.50	2,418.05	3,174.70	514.00	610.00	248,022.25



Sektori ndërtësive - Konsumi i energjisë (MWh/vit)




Figura 4: Paraqitje grafike e konsumit të energjisë për sektorin e ndërtësive

Në vijim në mënyrë grafike janë paraqitur pjesëmarrja e energjentëve në konsumin e përgjithshëm të energjisë në sektor, si dhe konsumi i energjisë së tërësishme sipas nën-sektorëve.




Figura 5: Pjesëmarrja e energjentëve në konsumin e përgjithshëm të energjisë në sektorin e ndërtësive



Konsumi sipas nënsektorëve




Figura 6: Konsumi në përqindje sipas nën-sektorëve

Nga tabela dhe grafiku i paraqitur më lart vërehet se energjia elektrike e furnizuar nga rrjeti kombëtar shënon përdorimin më të madh – 97.5% e pasuar nga nafta me 1.2%, gazi i lëngshëm 0.9%, ngrohja diellore përmes paneleve solare termike me 0.2%, dhe biomasa me 0.2%.

Për sa i përket nën-sektorëve duhet theksuar se, ashtu siç është e pritshme nëse u referohemi numrit të ndërtesave në Bashkinë e Durrësit, ndërtesat private të banimit kanë pjesëmarrjen më të madhe të konsumit me 74.1% e pasuar nga ndërtesat tregtare me 16.8%; ndërsa pjesëmarrja në konsumin e përgjithshëm të energjisë e ndërtesave publike bashkiake është 4.8% dhe ndriçimit publik 4.3%.

Shkarkimet e CO₂

Duke ju referuar strukturës së konsumit të energjisë në sektorin e Ndërtesave, edhe shkarkimet nga konsumi i energjisë elektrike përbëjnë pjesën dërmuese të shkarkimeve, ndërsa në sasi dukshëm më vogël pasojnë shkarkimet nga lëndët djegëse fosile si gazi i lëngëzuar dhe nafta. Duhet theksuar se faktori i shkarkimeve për biomasën (dhe BRE-të tjera) është marrë i barabartë me zero, në përputhje me kriteret e 'CO₂-neutralitetit', rrjedhimisht shkarkimet nga biomasa llogariten të jenë zero.

Në tabelën dhe grafikun më poshtë janë paraqitur shkarkimet nga energjentët sipas nën-sektorëve:



Tabela 4: Shkarkimet e CO₂ në sektorin e ndërtësive

Sektori i Ndërtësive - Emitimet e CO ₂ / Ekuivalent CO ₂ [ton/vit]						
Nënsektorët	Energji elektrike	Gaz i lëngshëm	Naftë / Dizel	Biomasa	Ngrohje diellore	Total
Ndërtesat publike bashkiake	815.85	4.22	14.29	0.00	0.00	834.36
Ndërtesat private të banimit	179,197.28	561.60	815.09	0.00	0.00	180,573.97
Ndërtesat private afariste	42,057.18	0.00	0.00	0.00	0.00	42,057.18
Ndriçimi publik	10,910.15	0.00	0.00	0.00	0.00	10,910.15
Total Sektori	232,980.46	565.82	829.38	0.00	0.00	234,375.66

Sektori ndërtësive - Emitimet e CO₂ (ton/vit)




Figura 7: Grafiku i shkarkimeve të CO₂ në sektorin e Ndërtësive

Në vijim grafikisht janë paraqitur pjesëmarrja e secilit energjent në shkarkimet e përgjithshëm në sektor dhe shkarkimet e përgjithshme sipas nën-sektorëve.






Figura 8: Pjesëmarrja e energjentëve në shkarkimet e përgjithshme në sektorin e Ndërtesave




Figura 9: Shkarkimet në përqindje sipas nën-sektorëve

Nga tabela dhe grafiku i paraqitur më lart vërehet se shkarkimet nga energjia elektrike e furnizuar nga rrjeti kombëtar janë në nivelin 99.4%, e pasuar nga nafta me 0.4%, gazi i lëngshëm 0.2%. Në përputhje me kriteret e 'CO₂-neutralitetit', shkarkimet nga biomasa janë llogariten të jenë zero.

Për sa i përket nën-sektorëve duhet theksuar se, ashtu siç është e pritshme nëse u referohemi numrit të ndërtesave në Bashkinë e Durrësit, ndërtesat private të banimit kanë pjesëmarrjen më të madhe të shkarkimeve me 77.0% e pasuar nga ndërtesat tregtare me 17.9%; përderisa pjesëmarrja e ndërtesave publike bashkiake në shkarkimet e përgjithshme është 0.4% dhe ndriçimit publik 4.7%.

3.2.2 Analiza për sektorin e transportit

Konsumi i energjisë - karburanteve

Fillimisht duhet theksuar se në sektorin e transportit përdoren dy energjentë kryesorë – karburante me prejardhje fosile – nafta (dizeli) dhe benzina. Po ashtu duhet vënë në dukje që konsumi i dizelit është mbi 3 herë më i madh se konsumi i benzinës. Në vijim paraqiten në mënyrë tabelare dhe grafike sasitë e konsumuara të këtyre karburanteve sipas nën-sektorëve të transportit.

Tab.5: Konsumi i energjisë – karburanteve në sektorin e transportit

Sektori i Transportit - Konsumi i energjisë / karburantëve [MWh/vit]			
Nënsektorët	Nafta (Dizeli)	Benzina	Total
Flota e automjeteve bashkiake	3,200.00	0.00	3,200.00
Transporti publik	0.00	0.00	0.00
Transporti privat e afarist	390,500.00	102,500.00	493,000.00
Total Sektori	393,700.00	102,500.00	496,200.00

Sektori i transportit - konsumi i energjisë [MWh/vit]




Figura 10: Konsumi i energjisë – karburanteve në sektorin e transportit

Në vijim grafikisht janë paraqitur pjesëmarrja e karburanteve në konsumin e përgjithshëm të energjisë në sektorin e transportit, si dhe konsumi i përgjithshëm i energjisë – karburanteve sipas nën-sektorëve.



Konsumi sipas karburanteve




Figura 11: Pjesëmarrja e karburanteve në konsumin e përgjithshëm të energjisë në sektorin e Transportit

Konsumi sipas sektorëve




Figura 12: Konsumi i energjisë / karburanteve në përqindje sipas nën-sektorëve

Nga tabela dhe grafiku i paraqitur më lart vërehet se vetëm dy lloje të karburanteve përdoren në sektorin e transportit: Nafta (dizeli) që konsumohet në masën 79.3 % dhe benzina që merr pjesë me 20.7% në konsumin e tërësishëm të karburanteve në këtë sektorë.

Duke ju referuar nën-sektorëve të Transport dhe numrit të automjeteve të nën-sektorëve përkatës, është e vetëkuptueshme që transporti privat dhe biznesit kanë pjesëmarrjen të mëdhe me 99.4%, ndërsa nën-sektorët e flotës së automjeteve bashkiake dhe transportit publik kanë pjesëmarrjen 0.6% të konsumit të përgjithshëm të karburanteve.



Shkarkimet e CO₂

Në përputhje me strukturën e konsumit të karburanteve në sektorin e Transportit, shkarkimet nga nafta / dizeli janë dukshëm më të mëdha se shkarkimet nga benzina, e cila është karburant më i pastër (me më pak shkarkime) se dizeli.

Në vijim paraqiten në mënyrë tabelare dhe grafike sasitë e shkarkimeve të CO₂ / CO₂ ekuivalent nga karburantet e përdorur sipas nën-sektorëve të transportit:

Tabela 6: Shkarkimet e CO₂ në sektorin e Transportit

Sektori i Transportit - Emitimet e CO ₂ / Ekuivalent CO ₂ [ton/vit]			
Nënsëktorët	Nafta (Dizeli)	Benzina	Total
Flota e automjeteve bashkiake	835.99	0.00	835.99
Transporti publik	0.00	0.00	0.00
Transporti privat e afarist	102,017.34	26,394.86	128,412.20
Total Sektori	102,853.33	26,394.86	129,248.19




Figura 13: Paraqitja grafike e shkarkimeve të CO₂ në sektorin e Transportit

Në vijim grafiksht janë paraqitur pjesëmarrja e secilit karburant në shkarkimet e përgjithshëm në sektor, si dhe shkarkimet e tërësishme sipas nën-sektorëve.



Sektori Transportit - emetimet sipas karburantëve




Figura 14: Pjesëmarrja e karburanteve në shkarkimet e përgjithshme të CO₂ / CO₂ ekuivalent në sektorin e Transportit

Sektori i transportit - emetimet sipas nënsektorëve




Figura 15: Shkarkimet e në përqindje të CO₂ / CO₂ ekuivalent sipas nën-sektorëve

Nga dhe grafiku i paraqitur më lart vërehet se shkarkimet nga nafta (dizeli) e përdorur në sektorin e transportit përbëjnë 79.6 %, ndërsa benzina ka pjesëmarrjen dukshëm më të vogël 20.4%; kjo kryesisht për faktin se konsumimi i benzinës në transport është dukshëm më i vogël se dizeli, por edhe për shkak se benzina ka shkarkime më të ulëta për njësi.

Ashtu siç është e pritshme, nëse ju referohemi numrit të makinave pra konsumit, nën-sektori i automjeteve private individuale dhe biznesit ka pjesëmarrjen ndjeshëm më të madhe me 99.4% ndërsa shkarkimet nga flota e automjeteve bashkiake janë vetëm 0.6%.



3.2.3 Analiza e Sektorëve jo-energjetikë – Sektori i Mbetjeve, Bujqësia dhe pyjet

Në vijim të ndarjes sektoriale janë analizuar shkarkimet nga: Sektori i mbetjeve të ngurta bashkiake; dhe sektori: Bujqësia, Pyjet dhe Përdorimet tjera të tokës.

Në BEI janë inventarizuar shkarkimet e CO₂ / CO₂ ekuivalent nga këto dy sektorë, siç paraqiten në tabelën dhe grafikun vijues.

Tabela 7: Shkarkimet nga sektorët jo-energjetik

Sektorët jo-energjetik - Emitimet e CO ₂ / Ekuivalent CO ₂	
Sektorët	Sasisë emitimeve [ton/vit]
Mbetjet e ngurta bashkiake	60,145.31
Bujqësia, Pyjet dhe përdorime tjera të tokës	82,074.00
Total	142,219.31

Emetimet e CO₂ / CO₂ ekuivalent [ton/vit] në sektorët jo-energjetik




Figura 16: Grafiku i shkarkimeve të sektorëve jo-energjetikë

Vërehet se shkarkimet nga këta dy sektorë janë përafërsisht të njëjta, ku Sektori i Bujqësisë, pyjeve dhe përdorimet tjera të tokës merr pjesë me 57.7%, ndërsa sektori i mbetjeve të ngurta bashkiake merr pjesë me 42.3%.



3.3 Analiza e përgjithshme e konsumit të energjisë dhe shkarkimeve të gazeve serë në territorin e bashkisë

Konsumi i energjisë

Në territorin e Bashkisë Durrës konsumi i energjisë është llogaritur për makro-sektorët e aktiviteteve:

- i) Ndërtesa, Impiante dhe Pajisje;
- ii) Transporti;
- iii) Bujqësia, Pyjet dhe përdorimet tjera të tokës; dhe Mbetjet e ngruta bashkiake;

Shpenzuesi më i madh i energjisë është sektori i transportit, i pasuar nga sektori i ndërtesave. Gjithashtu, konsumi i energjisë është llogaritur sipas energjentëve përkatës, ku nafta / dizeli paraqet energjentin më të konsumuar, e pasuar nga energjia elektrike dhe benzina, si dhe gazi i lëngshëm, biomasa ngrohja diellore që janë konsumuar në masë dukshëm më të vogël.

Në tabelën dhe grafikun vijues është paraqitur detaje të konsumit të energjisë në territorin e Bashkisë Durrës.

Tabela 8: Konsumi përfundimtar i energjisë në Bashkinë Durrës

Konsumi përfundimtar i energjisë [MWh/vit]							
Makro-sektorët / Energjentët	En. Elektrike	Gaz i lëngshëm	Naftë / dizel	Benzinë	Biomasë	Ngrohje diellore	Total
Ndërtesa, impiante e pajisje	241,305.50	2,418.05	3,174.70	0.00	514.00	610.00	248,022.25
Transporti	0.00	0.00	393,700.00	102,500.00	0.00	0.00	496,200.00
Bujqësia, Pyjet dhe përd. tjera të tokës	-	-	-	-	-	-	-
Mbetjet e ngruta bashkiake	-	-	-	-	-	-	-
Total	241,305.50	2,418.05	396,874.70	102,500.00	514.00	610.00	744,222.25




Figura 17: Paraqitja grafike e konsumit të energjisë në Bashkinë Durrës



Në vijim grafikisht janë paraqitur pjesëmarrja e energjentëve në konsumin e përgjithshëm të energjisë në territorin e bashkisë, si dhe konsumi i tërësishëm i energjisë sipas sektorëve të aktivitetit.




Figura 18: Pjesëmarrja e energjentëve në konsumin e përgjithshëm të energjisë në territorin e bashkisë




Figura 19: Pjesëmarrja e sektorëve të aktivitetit në konsumin e përgjithshëm të energjisë në bashki

Nga dhe grafiku i paraqitur më lart vërehet se nafta (dizeli) paraqet energjentin me pjesëmarrjen më të madhe në konsumin e përgjithshëm të energjisë – 53.3%, e pasuar nga energjia elektrike me 32.4%, benzina me 13.8%, si dhe energjentët me pjesëmarrje shumë të vogël: gasi i lëngshëm 0.3%, ngrohja diellore përmes paneleve solare termike me 0.08%, dhe biomasa me 0.07%.



Për sa i përket sektorëve të aktiviteteve duhet theksuar se, sektori i transportit ka pjesëmarrjen më të madhe të konsumit me 66.7%, përderisa sektori i Ndërtesave merr pjesë në konsumin e përgjithshëm të energjisë me 33.3%; përderisa për sektorët 'jo-energjetikë' konsumi i energjisë është zero.

Shkarkimet e CO₂

Përgjithësisht shkarkimet e CO₂ / CO₂ ekuivalent përcjellin strukturën e konsumit të energjisë dhe ndarjen sektoriale; kështu sasitë më të mesha të shkarkimeve derivojnë nga konsumi i energjisë elektrike, e pasuar nga nafta dhe benzina, përderisa shkarkimet nga gasi i lëngshëm janë dukshëm më të vogla për shkak të konsumit të vogël të këtij energjenti. Duhet theksuar se faktori i shkarkimeve për biomasë (dhe BRE-të tjera) është marrë i barabartë me zero në përputhje me kriteret e 'CO₂-neutralitetit', rrjedhimisht shkarkimet nga biomasa llogariten të jenë zero.

Sa i përket makro-sektorëve, sektori i Ndërtesave paraprin me sasinë më të madhe të shkarkimeve, e pasuar nga sektori i Transportit dhe dy sektorët 'jo-energjetikë': Bujqësia, pyjet e përdorimet tjera të tokës; dhe Mbetjet e ngurta bashkiake.

Në tabelën dhe grafikun më poshtë janë paraqitur shkarkimet nga energjentët sipas nën-sektorëve:

Tabela 9: Shkarkimet e përgjithshme të gazrave serë në territorin e Bashkisë Durrës

Emitimet e CO ₂ / Ekuivalent CO ₂ [ton/vit]							
Makro-sektorët / Energjentët	En. Elektrike	Gaz i lëngshëm	Naftë / dizel	Benzinë	Biomassë	Ngrohje diellore	Total
Ndërtesa, impiante e pajisje	232,980.46	565.82	829.38	0.00	0.00	0.00	234,375.66
Transporti	0.00	0.00	102,853.34	26,394.86	0.00	0.00	129,248.20
Bujqësia, Pyjet dhe përd. tjera të tokës	-	-	-	-	-	-	82,074.00
Mbetjet e ngurta bashkiake	-	-	-	-	-	-	60,145.31
Total	232,980.46	565.82	103,682.72	26,394.86	0.00	0.00	505,843.17






Figura 20: Grafiku i shkarkimeve të përgjithshme në territorin e Bashkisë Durrës

Në vijim grafikisht janë paraqitur pjesëmarrja e secilit energjent në shkarkimet e përgjithshme në bashki, si dhe shkarkimet e tërësishme sipas makro-sektorëve.

Emitimet e CO2 / Ekuivalent CO2 sipas energjentëve




Figura 21: Pjesëmarrja e energjentëve në shkarkimet e përgjithshme në territorin e Bashkisë Durrës



Emetimet e CO₂ / Ekuivalent CO₂ sipas sektorëve




Figura 22: Shkarkimet e përgjithshme të ndara sipas sektorëve

Nga tabela dhe grafiku i paraqitur më lart vërehet se shkarkimet nga energjia elektrike e furnizuar nga rrjeti kombëtar janë në nivelin 64.1%, e pasuar nga nafta me 28.5%, benzina me 7.3%, dhe gazi i lëngshëm me një pjesëmarrje dukshëm më të vogël prej vetëm 0.2%. Përderisa, në përputhje me kriteret e 'CO₂-neutralitetit', shkarkimet nga biomasa janë llogariten të jenë zero.

Për sa i përket nën-sektorëve duhet theksuar se, makro-sektori i Ndërtesave paraqet pjesëmarrjen më të madhe në shkarkimet e përgjithshme me 46.3% e pasuar nga Transporti me 25.6%; përderisa pjesëmarrja e sektorë 'jo-energjetikë' në shkarkimet e përgjithshme po ashtu është e konsiderueshme: sektori i Bujqësisë, pyjeve dhe përdorimet tjera të tokës 16.2% dhe sektori i mbetjeve të ngurta bashkiake 11.9%.

Shkarkimet e gazrave serë në të gjithë territorin e Bashkisë Durrës në vitin bazë, paraqesin rreth 4.7% të shkarkimeve të përgjithshme në nivel kombëtar.



4. VLERËSIMI I RREZIKUT DHE CENUESHMËRISË (RVA)

Ky kapitull i kushtohet vlerësimit të dobësive dhe rreziqeve në lidhje me ndryshimet klimatike (RVA) për sektorë të ndryshëm në qytetin e Durrësit.

Sektorët e përzgjedhur nga raportet e mëparshme dhe takimet tematike të këtij procesi strategjik, me përfaqësues të Bashkisë dhe institucioneve vendore, u vlerësuan si më të ndjeshëm në lidhje me ndryshimet e pritshme klimatike në të ardhmen. Në të njëjtën kohë ato vlerësohen si sektorët më të spikatur për zonën e qytetit. Gjatë përgatitjes së analizës së një sektori të caktuar mbi ndikimet e ndryshimeve klimatike, u parashikuan hapat bazë, përkatësisht:

- i) Përcaktimin e rreziqeve të pasojave të ndryshimeve klimatike, të cilat janë domethënëse për qytetin e Durrësit;
- ii) Përcaktimi i karakteristikave kryesore aktuale dhe në të ardhmen të çdo rreziku të identifikuar (probabiliteti i shfaqjes, ndryshimet e pritshme në intensitet, periudha kohore e veprimit), etj;
- iii) Përcaktimi i sektorëve socio-ekonomikë dhe mjedisorë që janë më të ekspozuar ndaj rreziqeve të identikuara (ndërtesat, trafiku, energjia, furnizimi me ujë, menaxhimi i mbetjeve, planet e përdorimit të tokës, bujqësia dhe pylltaria, mjedisi dhe biodiversiteti, shëndetësia, mbrojtja civile dhe shërbimet e urgjencës, turizmi, arsimi, teknologjitë e informacionit dhe komunikimit), si dhe niveli i ndjeshmërisë së tyre klasifikuar (i lartë, i moderuar, i ulët);
- iv) Përcaktimi i grupeve sociale më të ndjeshme ndaj çdo rreziku të identifikuar;

Një element tjetër i rendësishëm është dhe vlerësimi i aftësisive/mundësive të Bashkisë së Durrësit për t'u përshtatur me rreziqet e identikuara, që nënkupton vlerësimin për cdo kategori ekzistuese të shërbimeve publike të: disponueshmërisë së aktorëve socio-ekonomikë; pajtueshmërisë dhe zbatimin e rregulloreve; kapacitetet njerëzore dhe pajisjet; si dhe e sistemet e paralajmërimit të hershëm.

4.1 Metodologjia për vlerësimin e cenueshmërisë dhe rrezikut nga ndryshimet klimatike të Bashkisë Durrës.

Metodologjia e përdorur në RVA është bazuar në Manualin për Zhvillimin të Planit të Veprimit për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Energjisë dhe Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike, (*The Covenant of Mayors for Climate and Energy Reporting Guidelines*), si dhe i Planit të Veprimit për Energjinë e Qëndrueshme dhe Lufta kundër Ndryshimeve Klimatike, e cila u hartua bazuar në nismën e Marrëveshjes së Kryetarëve dhe Zyra e Kryetarëve të Bashkive, në bashkëpunim me Qendrën e Përbashkët të Kërkimeve të Komisionit Evropian (JRC).

RVA është themeli mbi të cilën bazohen masat e ardhshme të përshtatjes ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike të njësisë së vetëqeverisjes vendore (NJQV), si njësi më vete dhe në të

njëjtën kohë është bazë dhe pjesë përbërëse e dokumentit të Planit të Veprimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Energjisë dhe Klimës (SECAP), për njësinë e vetëqeverisjes vendore.

4.1.1 Termat bazë të vulnerabilitetit

Termtat bazë të vulnerabilitetit dhe analizës së rrezikut përfshijnë:

- i. nxitësit klimatikë dhe jo-klimatikë të ndryshimeve klimatike;
- ii. rreziqet/kërcënimet;
- iii. ekspozimin;
- iv. ndjeshmërinë dhe
- v. kapacitetin adaptues.

Rezultati përfundimtar i procesit të analizës së cenueshmërisë dhe rrezikut është karakterizimi i rreziqeve të ndryshimeve klimatike për zonën në studim.

Terminologjia e përdorur në metodologji është në përputhje me IPPC Ar5.

Rreziku, kërcënimi, ngjarja e rrezikshme, etj., përkufizohet si "një dukuri e mundshme e një ngjarjeje ose tendence të shkaktuar nga natyra ose nga njeriu, si një efekt që mund të shkaktojë humbje jete, lëndime ose pasoja të tjera shëndetësore, si dhe dëme materiale dhe humbje të pronës, infrastrukturës, mjeteve të jetesës, shërbimeve dhe burimeve mjedisore". Rreziqe të ndryshme, p.sh. përmbytjet, thatësitat apo valët e të nxehtit, prekin sektorë të ndryshëm në zonën e vëzhguar. Rreziqet janë pasoja të drejtpërdrejta të ndryshimeve klimatike, (p.sh. rritja e temperaturës mesatare të ajrit, mungesa/intensifikimi i reshjeve, shperndarja e ndryshme në kohë dhe hapësirën e tyre, etj.), si dhe ndikime të tjera të shkaktuara nga aktiviteti njerëzor, si mbipopullimi, zvogëlimi i sipërfaqeve të gjelbra, ndërhyrjet e pakontrolluara në shtetërit e lumenjve, etj. Sa më i shpeshtë dhe më intensiv të jetë rreziku, aq më i madh është pasoja e tij.

Ekspozimi ndaj fenomeneve të sipërpërmendura i jep një përgjigje pyetjes se çfarë rrezikohet potencialisht nga një ngjarje e rrezikshme në zonën e vëzhguar dhe cili është faktori vendimtar në përcaktimin e dëmeve dhe humbjeve të mundshme. Ekspozimi përfshin "praninë e njerëzve, mjeteve të jetesës, llojeve ose ekosistemeve, shërbimeve dhe burimeve mjedisore, infrastrukturës ose aseteve ekonomike, sociale ose kulturore në vende që mund të ndikohen negativisht nga fenomenet klimatike".

Cenueshmëria ndaj një ngjarjeje të caktuar të rrezikshme përfaqëson një predispozicion ndaj ndikimeve negative dhe është funksion i dy variablave të veçantë, ndjeshmërisë dhe aftësisë përshtatëse.

Pjesë të ndryshme të zonës në studim janë ndryshueshmërisht të ndjeshme ndaj veprimit të një ngjarjeje të rrezikshme, e cila përshkruhet me termin sensibilitet, i cili përkufizohet si "shkalla në të cilën kërcënimi i konsideruar mund të ndikojë në objektin e ekspozuar, ekosistemin në përgjithësi, ose speciet në vecanti, qoftë në mënyrë të pafavorshme ose të favorshme dhe efekti mund të jetë i drejtpërdrejtë ose i tërthortë".



Kapaciteti përshtatës nënkupton: *aftësinë e shoqërisë, komuniteteve, Institucioneve apo mjedisit në përgjithësi për t'u përshtatur dhe për t'iu përgjigjur ndikimeve aktuale dhe të ardhshme të ndryshimeve të klimës.*

Reziku – që në vetvetë nënkupton probabilitetin e ndodhjes së një ngjarjeje ose tendence të rrezikshme, e cila përfaqëson mundësinë e ndodhjes së një ngjarjeje të caktuar. Ai është rezultat i ndërlikohjes së cenueshmërisë, ekspozimit dhe ngjarjes së rrezikshme dhe tregon një vlerësim se si kërcënimi mund të ndikojë në një sektor/mjedis të caktuar ose në disa prej tyre njëkohësisht.

Cenueshmëria ndaj një ngjarjeje të caktuar të rrezikshme varet nga ekspozimi, ndjeshmëria dhe aftësia për t'u përshtatur.

Arsyetimi është mbështetur në parimet e rëndësishme që:

- Ndjeshmëria e madhe dhe mundësia e pakët për adaptim rrisin cenueshmërinë;
- Shpeshtësia e ngjarjeve ekstreme, si dhe rritja e intensitetit të tyre, shkaktojnë cenueshmëri më të lartë dhe si rrjedhim rrezik më të lartë për pasoja në shoqëri dhe mjedis.

Të dhënat dhe informacioni i përdorur gjatë kryerjes së vlerësimeve të sipërpërmendura janë mbledhur nga burimet e mëposhtme:

- Njohuritë dhe përvoja e anëtarëve të ekipit të Bashkisë Durrës, të mbledhura përmes takimeve dhe konsultimeve përkatëse ku u grumbullua informacion në lidhje me kërcënimet e mëparshme, aktuale dhe ato të mundshme në të ardhshmen të ndryshimeve të klimës dhe ndikimin e tyre në sektorët kyç si p.sh. shëndetësia, arsimi, mbrojtja civile, ekonomia dhe industria, etj., dhe ndikimi në grupet e cenueshme të popullsisë;
- Materialet dhe dokumentat e dorëzuara nga Bashkia Durrës në lidhje me kërcënimet e mëparshme klimatike që kanë ndodhur në territorin e qytetit të Durrësit;
- Dokumentet përkatëse strategjike dhe planifikuese të qytetit të Durrësit me karakter kombëtar dhe vendor;
- Studime të organizmave ndërkombëtare për zonën apo dhe më gjerë;
- Të dhëna të Instituti të GjeoShkencave dhe Mjedisit (IGJEO), si dhe rishikimi i të dhënave historike për klimën, reshjet, temperaturat, etj.;
- Raportet kombëtare për Shqipërinë në kuadër të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike;

Bazuar në udhëzimet e Manuali për zhvillimin e Planit të Veprimit për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Energjisë dhe Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike, dhe në Marrëveshjen e Kryetarëve të Bashkive për Klimë dhe Energji, u krye një vlerësim i rreziqeve aktuale ndaj ndryshimeve të klimës, përkatësisht:

- Probabilitetet e shfaqjes së kërcënimit klimatik;
- Ndikimet e kërcënimit klimatik;



Klasifikimi i përdorur për të vlerësuar kërcënimet aktuale të klimës u bazua ne arsyetimin:

- **Konsiderohet i ulët** – Në rast se probabiliteti i shfaqjes së një kërcënimi klimatik është (p.sh. një herë në një dekadë) dhe kur ndikimi i tij është pothuajse i papërfillshëm (përsa i përket ndikimit në njerëz, pronë, mjedis, infrastrukturë, ekonomi, etj.)
- **Konsiderohet i moderuar** – Në rast se probabiliteti i ndodhjes së kërcënimit klimatik është periodik (i shpeshtë, një herë në disa vite), dhe kur ndikimi është i moderuar (përsa i përket ndikimit tek njerëzit, pronë, mjedis, infrastrukturë, ekonomi, etj.)
- **Konsiderohet i lartë** – Në rast se kërcënimi klimatik ndodh shpesh, (një herë në disa vjet ose në baza vjetore), dhe kur ndikimi i tij është shumë i ndjeshëm (përsa i përket ndikimit në njerëz, pronë, mjedis, infrastrukturë, ekonomi, etj.)
- **Konsiderohet i papërcaktuar** – kur një kërcënim klimatik nuk shfaqet ose shfaqja e tij nuk monitorohet, dhe kur ndikimi i tij është i papërcaktuar, (përsa i përket ndikimit në njerëz, pronë, mjedis, infrastrukturë, ekonomi, etj.)

Vlerësimi i kërcënimeve të pritshëm klimatikë paraqitet përmes ndryshimeve të pritshme në intensitetin e rreziqeve klimatike, ndryshimeve të pritshme në frekuencat dhe hapësirë kohore në të cilën ndodh ky ndryshim.

Duke pasur parasysh rreziqet që shfaqën në zonën e qytetit të Durrësit referuar periodhat e mëparshme dhe në bazë të dokumentacionit të mbledhur në lidhje me shfaqjen e këtyre fenomeneve, si dhe dokumentet e planifikimit strategjik, projeksionet dhe vlerësimet e kërcënimeve të ardhshme klimatike dhe parametrat klimatikë, u përcaktuan kërcënimet me të rëndësishme klimatike që mund të shfaqen në të ardhmen në territorin e Bashkisë së Durrësit.

Duke vlerësuar ndikimin e kërcënimeve të rëndësishme klimatike në sektorë të caktuar dhe duke konsideruar dobësitë e sektorëve, shkalla e përdorur për të vlerësuar nivelin aktual të cenueshmërisë/rrezikut u klasifikua:

- **I ulët** – Kur niveli i cenueshmërisë së sektorit është i ulët për sa i përket ndikimit të papërfillshëm mbi njerëzit, mjedisin, pronën, infrastrukturën dhe dëmin e ulët material të shkaktuar nga kërcënimi klimatik në sektorin përkatës;
- **I moderuar** – Kur niveli i cenueshmërisë së sektorit është i moderuar, për sa i përket ndikimeve të rëndësishme në jetë njerëzore, mjedis, pronën, infrastrukturë, por me nivelet mesatare-të larta të dëmit material të shkaktuar nga kërcënimi klimatik në sektorin përkatës.
- **I lartë** – Kur niveli i cenueshmërisë së sektorit është i lartë për sa i përket ndikimit negativ domethënës mbi njerëzit, mjedisin, pronën, infrastrukturën dhe një shkallë shumë të lartë të dëmit material të shkaktuar nga kërcënimi klimatik në sektorin e dhënë.
- **E panjohur** -Kur niveli i cenueshmërisë së sektorit është i panjohur për sa i përket ndikimit negativ mbi njerëzit, mjedisin, pronën, infrastrukturën dhe shkallën e dëmit material të shkaktuar nga kërcënimi klimatik në sektorin e dhënë.



4.2 Ndryshimet klimatike

Pasojat negative të ndryshimeve klimatike janë tashmë të dukshme në Shqipëri. Të gjitha raportet e mëparshme lidhur me ndryshimet klimatike, të cilat vendi ynë i harton si nënshkrues i Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, konfirmojnë se këto ndryshime pritet të ndodhin gjithnjë e më intensivisht gjatë viteve në vazhdim.

Në Raportin e Katërt Kombëtar për Shqipërinë të Konventën Kuadër të OKB-së për Ndryshimet Klimatike, theksohet se analizat e ndryshimeve të temperaturës dhe regjimeve të reshjeve në periudhën nga viti 1961 deri në vitin 2016 tregojnë një rritje të ndjeshme të temperaturës në të gjitha zonat e vendin tonë, rritje të numrit dhe frekuencës së ditëve të nxehta me temperatura relativisht të larta, një ulje e numrit të ditëve të ftohta dhe një frekuencë më e ulët e temperaturave të ulëta, si dhe tendenca e një rritje të lehtë të rreshjeve vjetore me ndryshime të ndjeshme në shpërndarjen stinore të tyre.

Vlerësimet e ndryshimeve të ardhshme klimatike bazohen në projeksionet e shkarkimeve të gazeve serë që marrin parasysh parametrat e zhvillimit të ardhshëm demografik, social, ekonomik dhe teknologjik në nivel global dhe rajonal. Nëse shkarkimet globale të gazeve serë ruajnë tendencën e disa dekadave të fundit, klima e Shqipërisë do të bëhet mesatarisht më e ngrohtë në krahasim me kushtet klimatike të mesit të shekullit të njëzetë, me ndryshime të padëshirueshme në intensitetin dhe frekuencën e rreshjeve ekstreme dhe fenomeneve të tjera klimatike.

Modelet Rajonale të Klimës (RCM) përdoren për të vlerësuar ndryshimet klimatike në zona të veçanta. Këto modele janë mjetet më të përdorura për rajonalizimin e rezultateve të modeleve klimatike globale dhe vlerësimin e ndryshimit të kushteve klimatike rajonale në të ardhmen në varësi të skenarëve të ndryshëm të rritjes së mundshme të përqendrimeve të gazeve serrë.

4.2.2 Vlerësimi i ndryshimeve klimatike të ardhshme në zonën e qytetit të Durrësit

Gjiri i Durrësit nga pikëpamja klimatike bën pjesë në zonën Klimatike Mesdhetare Fushore Qendrore. Klima e kësaj zone karakterizohet nga dimra të butë dhe të lagësht dhe vera të nxehta dhe të thata. Elementet më të rëndësishëm klimatike që lidhen me projektin janë temperatura e ajrit, rreshjet dhe era.

Bazuar në të dhëna historike të IGJEO dhe Raporteve Kombëtare për Shqipërinë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, mund të thuhet se temperaturat e ajrit do të vazhdojnë të rriten në vitet në vazhdim. Rritja e temperaturave bën që kufijtë e saj dhe regjimit të rreshjeve të ndryshojnë në kohë.



Sic vihet re dhe nga harta e temperaturave referuar vlerave bazë të temperaturës mesatare në vitin 1990, temperaturat pritet të rriten me mesatarisht me rreth 2⁰, deri në vitin 2050 dhe mesatarisht deri me 4⁰, deri rreth viteve 2100. Parashikohet gjithashtu një rritje e ekstremeve të temperaturës, e cila mund të ketë një ndikim edhe me të ndjeshëm në jetë njerëzore, ekonomi dhe shoqëri.




Figura 23: Temperatura e verës, vlera bazë dhe e pritshme deri në vitet 2050 dhe 2100 për zonën bregdetare.⁷

Referuar Raportit të Katërt Kombëtar për Shqipërinë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, një element mjaft i rëndësishëm që duhet konsideruar në hartimin e RVA, janë dhe parashikimet për reduktimin pritshëm të sasisë së rreshjeve dhe rritjen e intensitetit të tyre.

Duke përgjithësuar rezultatet e skenarëve të ndryshëm që lidhen me ndryshimet klimatike lidhur me rreshjet, arrijmë në përfundimin se rreshjet si mesatare vjetore ka të ngjarë të ulen deri në -8,5% (nga 47,4 në -56,0%) rreth vitit 2050; dhe deri në -18.1% (nga 94.0 në -89.7%) rreth vitit 2100.



⁷ Raportit të Tretë Kombëtare për Shqipërinë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike

Tabela 10. Parashikimi i ndryshimit të reshjeve (%), për horizonte të ndryshme kohore lidhur me vitin 1990*

Years	2030	2050	2080	2100
Annual	-3.84 (-35.4 to 27.7)	-8.46 (-56.0 to 47.4)	-14.37 (-78.6 to 81.1)	-18.13 (-89.7 to 94.9)
Ënter	-5.96 (-15.9 to 4.0)	-10 (-27.9 to 7.7)	-14.3 (-44.6 to 16.1)	-18.1 (-55.8 to 19.6)
Spring	-2.45 (-11.9 to 7.0)	-7.26 (-25.3 to 10.75)	-14.26 (-45.1 to 16.6)	-17.7 (-55.3 to 19.8)
Summer	-10.4 (-12.8 to -7.9)	-19.7(-24.1 to -15.3)	-41.9 (-49.2 to -34.5)	-50.4 (-59.4 to -41.3)
Autumn	0.5 (-10.1 to 11.1)	-2.5 (-21.3 to 16.3)	-6.9 (-38.1 to 25.2)	-9.5 (-48.1 to 29.1)

Për vlerësimin e situatës aktuale të elementeve kryesorë klimatike u morën në konsideratë edhe të dhënat dhe konkluzionet e Planeve të Menazhimit të ujerave për lumenjtë Ishëm dhe Erzen të cilat përshkojnë territorin e Bashkisë Durrës.

Figura në vazhdim jep hartën e stacioneve meteorologjike të zonës në studim, nga ku janë përzgjidhur disa stacione vendodhja e të cilave paraqet në mënyrë më të besueshme parametrat termik dhe hidrik të zonës.




Figura 24: Harta e stacioneve hidro-meteorologjike të monitorimit në basenet lumorë të Ishmit dhe Erzenit,

* Raportit të Tretë Kombëtare për Shqipërinë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike

Tabelat në vazhdim paraqesin shpërndarjen brenda vjetore të rreshjeve mesatare vjetore të tre stacioneve hidrometrike të basenit të lumit Erzen, duke filluar nga pjesa e sipërme e basenit zona malore deri në matjet në pjesën e ulët fushore të zonës administrative të Bashkisë Durrës.

A) Station Dajt – 1548 mm/year - altitude 705 m



B) Station Petrele – 1386 mm/year – altitude 320 m



C) Station Likmetaj – 929 mm/year – altitude 155 m





Figura 25: Regjimi i rreshjeve mujore në tre stacione të basenit ujqor të lumit Erzen




Tabelat në vazhdim japin shpërndarjen vjetore të prurjes mesatare në lumin e Erzenit në tre stacione, referuar shtrirjes gjeografike të basenit nga pjesa e sipërme në atë të poshtme të tij.

A) River Erzen – Station Ibë – Mean Annual Flow = 6.4 m³/s, Q50 = 6.1 m³/s



B) River Erzen – Station Ndroq – Mean Annual Flow = 13.3 m³/s, Q50 = 11.30 m³/s



C) River Erzen – Station Sallmonaj – Mean Annual Flow = 15.3 m³/s, Q50 = 12.3 m³/s




Figura 26: Regjimi rrjedhës ujore në tre stacione të basenit ujqor të lumit Erzen

Nga sa më sipër shqetësimet kryesor që duhen konsideruar përfshijnë:

- frekuenca dhe kohëzgjatja në rritje e valëve të të nxehtit, të cilat do të përbëjnë rreziqe të konsiderueshme për shëndetin, veçanërisht në pellgjet e lumenjve me



- lartësi të ulëta, ku ndodhen shumë qendra urbane me popullsi të dendur, ku bën pjesë edhe qyteti i Durrësit;
- ii. rritje e theksuar e potencialit për zjarre në pyje;
 - iii. zvogëlimi i prurjeve vjetore të lumenjve, që mund të prishë disponueshmërinë e ujërave të ëmbla, të ndikojë në ekosistemet, si dhe disa sektorë socio-ekonomikë, duke vështirësuar sigurimin e ujit të pijshëm, atë për bujqësinë dhe industrinë;
 - iv. rritje e ndjeshme e tendencave të intensitetit dhe ashpërsisë së thatësisë, që prek qytetarët dhe shumicën e sektorëve ekonomikë, veçanërisht bujqësinë dhe prodhimin e energjisë;
 - v. rritje të rezikut për jetet njerëzore, sigurinë, cilësinë e jetës dhe stabilitetin ekonomik.

Fenomene të tilla si përmytjet dhe thatësira përvec ndikimit të faktorëve klimatikë janë subjekt i balancës ujore në seksionin lumor në njësinë e kohës prandaj dhe meren gjithmonë parasysh për të arsyetuar dhe paraprirë fenomeneve të ndryshimeve klimatike të mundshme.

Bilanci uhor vlerësohet:

Sasia e ujit disponibël UD = Reshjet – Σ e përdoruesve – rimbushjen e ujërave nëntokësore - avullimin

Meqenëse UD është përgjithësisht një sasi fikse e fundme, dhe me shumë mundësi referuar studimeve të fenomeneve klimatike, ato edhe për shkak të këtyre ndryshimeve klimatike, mbeten kritike gjë që kërkon që menaxhimi i konsumit dhe sidomos nivelet e ujit duhet të menaxhohet në mënyrë rigorozë, në mënyrë që ti përgjigjen sa më mirë dhe në kohë si përballimit të përmytjeve po ashtu dhe fenomeneve të thatësisë të cilat po bëhen gjithnjë dhe më shqetësuese.

Me rritjen gjithnjë e më shumë të kërkesave për ujë të pijshëm për shkak edhe të rritjes së popullsisë dhe rritjes ekonomike, të gjithë përdoruesit e ujit kanë detyrimin të minimizojnë dhe optimizojnë përdorimin e tyre të ujit.

Vlerësimi i balancave të ujit në një rrjedhë ujore na ndihmon të arsyetojmë dhe strukturojmë aktorët kryesorë dhe influencën e sejcilit prej tyre në ciklit hidrologjik natyror të rrjedhës ujore (pa presione njerëzore), si dhe inputet dhe outputet përkatëse për shkak të ndikimeve njerëzore (p.sh. marrjen/përdorimin e ujit, shkarkimet, etj.) në një mënyrë koherente dhe të menaxhueshme.

Institucionet qendrore dhe sidomos ato vendore kanë për detyrë ligjore të sigurojë ruajtjen e burimeve natyrore në përgjithësi dhe ato ujore në vecanti për qëndrueshmërinë afatgjatë mjedisore dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të zonës. Institucionet vendore nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në Këshillin e Basenit Ujore duhet të synojnë mbrojtjen e mjedisit të përgjithshëm uhor nëpërmjet vendimarrjes në këtë Këshill.

Një element tjetër i rëndësishëm i këtij dokumenti është të mbështesë vendimmarrjen në lidhje me menaxhimin e ujërave të zeza, i cili mund të ndihmojë me zbatimin e Direktivës së BE-së për Trajtimin e Ujërave të Zeza Urbane (UWWTD).



Studimet dhe përvojat tregojnë se zgjidhjet e bazuara në mjedis janë ato me efikasitet, të cilat mund të zbatohen nëpërmjet tre drejtimeve kryesore për veprim:

- i. ruajtja dhe përdorimi më i mirë i ekosistemeve ekzistuese funksionale;
- ii. përmirësimi i menaxhimit të ekosistemit për përdorim të qëndrueshëm njerëzor, dhe
- iii. restaurimi i ekosistemeve të degraduara ose rinatyrimi i ekosistemit, (ose edhe krijimi i ekosistemeve e reja).

Nismat e ruajtjes që mund të mbrojnë, menaxhojnë dhe rivendosin në mënyrë të qëndrueshme mjedisin duke ofruar njëkohësisht përfitime të prekshme dhe të qëndrueshme për njerëzit, njihen gjerësisht si zgjidhje të bazuara në natyrë (NbS). Është dokumentuar se veprimet NbS, nëse projektohen mirë, mund të gjenerojnë të ardhura për komunitetet vendore të prekur nga efektet klimatike dhe të krijojnë përfitime për bashkitë dhe njesitë e vetëqeverisjes vendore, që varen nga këto burime natyrore duke siguruar shëndetin dhe mirëqenien e tyre.

Standardi NbS si veprime për të mbrojtur, menaxhuar dhe rivendosur në mënyrë të qëndrueshme ekosistemet natyrore në një mënyrë që adreson në mënyrë efektive dhe përshtatëse sfidat e komunitetit, për të siguruar si mirëqenien njerëzore ashtu edhe përfitimet e biodiversitetit.



5 Masat Zbutëse

5.1 Qasja në përzgjedhjes së masave zbutëse

Në përzgjedhjen e masave zbutëse, Bashkia Durrës ka përvetësuar qasjen e avancuar të qeverisjes urbane të energjisë dhe klimës duke ndërthurur katër modalitete kryesore:

- Vetë-qeverisja bashkiake – aktivitetet qeverisëse për investime të efijencës së energjisë në asetet bashkiake;
- Qeverisja përmes dhënies së mundësive – rol udhëheqës për të mundësuar bashkëpunimin mes aktorëve të komunitetit;
- Qeverisja përmes ofrimit - përmes ofrimit të shërbimeve bashkiake nxit zhvillimin e infrastrukturës përkatëse efijente të energjisë dhe transportit të qëndrueshëm; dhe
- Qeverisja përmes autoritetit – kompetenca për nxjerrjen e rregulloreve dhe planeve urbane që nxisin efijencën e energjisë dhe transportit urban efikas.

Në përputhje me Udhëzimet e Konventës së Krye-bashkiakëve (CoV – ‘Covenant of Mayors’) masat zbutëse janë strukturuar sipas sektorëve të aktiviteteve të përcaktuar në Inventarin Bazë të Shkarkimeve (BEI-Baseline Emission Inventory); konkretisht në:

- Makro-sektorët e energjisë:
 - Sektori Ndërtesave, Impianteve dhe Pajisjeve (shkurtimisht: Sektori Ndërtesave); dhe
 - Sektori transportit urban (brenda territorit të bashkisë).
- Sektorët ‘jo-energjetikë’:
 - Sektori mbetjeve; dhe
 - Bujqësia, Pylltaria dhe përdorimet tjera të tokës.

Tabela 11: Tabelë përmbledhëse e uljes së shkarkimeve prej masave të identifikuara


Masa	2015		2030		2030 vs 2015			
	Kons. En. [MWh/vit]	Emetimet Co2 [ton/vit]	Kons. En. [MWh/vit]	Emetimet Co2 [ton/vit]	Zvog kons [MWh]	Ulja emet [ton]	Zvog kons [%]	Ulja emet [%]
Sektori Ndërtesat, Impiantet e Pajisjet	248,022.25	234,375.67	113,696.15	95,911.63	134,326.10	138,464.04	54.16%	59.08%
Sektori Transportit	496,200.00	129,248.20	262,403.70	68,349.98	233,796.30	60,898.22	47.12%	47.12%
Sektorët 'jo-energjetikë'	N/A	142,219.31	N/A	117,496.92	N/A	24,722.39	N/A	17.38%
Total Bashkia Durrës	744,222.25	505,843.18	376,099.84	281,758.53	368,122.41	224,084.65	49.46%	44.30%



5.2 Detajet e masave zbutëse

5.2.1 Sektori i ndërtesave – ndërtesat publike në pronësi të bashkisë

Masa 1	
Emërtimi i masës:	Rinovimi i ndërtesave publike bashkiake për të përmirësuar eficiencën e energjisë
Sektori / Nën-sektori	Ndërtesat – Ndërtesat publike në pronësi të bashkisë
Organizata dhe departamenti Përgjegjës	Bashkia Durrës – Drejtoria e projekteve dhe infrastrukturës publike; Drejtoria e buxhetit; dhe Drejtoria e ekonomisë
Partnerët në zbatim	Organet dhe mekanizmat e Qeverisë Qendrore; Organizatat dhe Institucionet Financiare Ndërkombëtare
Periudha e zbatimit (fillimi – përfundimi)	2019-2030
Vlerësimi i kostos së zbatimit (ALL/EUR)	56,250,000
Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)	249.94
Prodhimi i energjisë nga BRE-të (MWh)	N/A
Vlerësimi i reduktimit të shkarkimeve (tCO ₂)	202.12
Burimet e financimit	Buxheti i Bashkisë Durrës; Fondi Shqiptar i Zhvillimit; Financime private/PPP; Organizatat ndërkombëtare donatore – GIZ, USAID, UNDP, SECO etj; Fondet e EU; dhe Institucionet Financiare Ndërkombëtare; ECRB, EIB, KfW, BBK, IFC, etj.
Përshkrimi i masës	Planifikohet rinovimi i të gjitha ndërtesave bashkiake, ndërsa rinovimi do të përfshijë:



	- Zëvendësimin e dritareve të vjetra me dritare të reja me performancë të lartë termike nga PVC me xhama të dyfishtë / trefishtë; - Zëvendësimi i dyerve – me përparësi dyert e jashtme; - Vendosja e termo-izolimit në muret e jashtme të ndërtesave – rinovimi i tërësishëm i fasadave; - Izolimi termik i çative të ndërtesave bashkiake që në shumicën e ndërtesave përfshin edhe rinovimin e plotë të çative; Në fazën përgatitore, nga bashkia / drejtoritë përkatëse duhet të ndërmerren këto aktivitete: - Përcaktimi i ndarjeve buxhetore dhe/ose mënyrave tjera të financimit alternativ; - Auditimi energjetik i ndërtesave publike bashkiake; - Përgatitja e dokumentacionit të projektit dhe tenderit për përzgjedhjen e ekzekutuesit të punimeve rinovuese; - Përzgjedhja e organit mbikëqyrës Me rinovimin e ndërtesave bashkiake parashikohet një kursim i dukshëm i energjisë elektrike të konsumuar për ngrohjen / ftohjen e hapësirave, si dhe energjentëve tjerë që veçanërisht përdoren për ngrohje. Bashkia Durres janë realizuar përafërsisht 70 objekte të përfunduara dhe 19 objekte në buxhet për investime nga 180 objekte
--	---

Masa 2	
Emërtimi i masës:	Instalimi i një sistem eficient të ndriçimit në ndërtesat publike bashkiake
Sektori / Nën-sektori	Ndërtesat – Ndërtesat publike në pronësi të bashkisë
Organizata dhe departamenti Përgjegjës	Bashkia Durrës – Drejtoria e projekteve dhe infrastrukturës publike; Drejtoria e buxhetit; dhe Drejtoria e ekonomisë
Partnerët në zbatim	Organet mekanizmat e Qeverisë Qendrore; Organizatat dhe Institucionet Financiare Ndërkombëtare
Periudha e zbatimit (fillimi – përfundimi)	2019-2030
Vlerësimi i kostos së zbatimit (AL/EUR)	1,750,000
Vlerësimi i kursimit të energjisë (MWh)	45.65
Prodhi i energjisë nga BRE-të (MWh)	N/A



Vlerësimi i reduktimit të shkarkimeve (tCO₂)	36.91
Burimet e financimit	Buxheti i Bashkisë Durrës Fondi Shqiptar i Zhvillimit; Organizatrat ndërkombëtare donatore – GIZ, USAID, UNDP, SECO etj; Fondet e EU; dhe Institucionet Financiare Ndërkombëtare; ECRB, EIB, KfW, BB-IFC, etj.
